

**DI**  
DRITA ISLAME



*Kombi ka nevojë për*

*fenjë*



# Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”  
Botim i Komunitetit Mysliman  
të Shqipërisë

DREJTOR  
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR  
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA  
Erzen Carja

KONTAKT:  
Tel/fax 04 223 04 092  
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXIII i botimit  
Nr. 11 (498)  
Nëntor, 2024

ISSN 2226-7115



Artikujt  
që vijnë në redaksi  
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht  
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,  
pavarësisht nëse botohen apo jo,  
nuk i kthehen autorit.

## PËRMBAJTJA

4 Kombi ka nevojë për fenë / Mehmet Disha

6 Dashuria dhe besnikëria ndaj atdheut, virtyte të besimtarit / Dorian Demetja

8 Lajme / Aktivitete



12 Roli i prijësve myslimanë në formimin e shtetit të parë shqiptar / Dr. Mojs Kamberi

16 Gjuha shqipe dhe shtetformimi në veprat e dijetarëve islam / Ismet Osmani


18 Dropshipping në këndvështrimin Islam / Këshilli i çështjeve fetare - insi.al

20 Ne jemi faji dhe zgjidhja / Gazmend Aga

24 A e njohin kafshët fizikën e fluturimit? / Prof. Dr. Ifan Yilmaz

28 Të gjesh qetësi me ibadet / Ajshe Nur


30 Profeti ynë cakton mësues, që të shkonin nëpër qyteza të  
ndryshme dhe t'u mësonin njerëzve Islamit / M. Jusuf Kandeheui



32 Fetvaja e H. Vehbi Dibrës në lidhje me përdorimin  
e flamurit me shqiponjë / Redaksia

34 Hafiz Ibrahim Dalliu për çështjen kombëtare / Doc. Musa Kraja

38 Atdheu / Naim Frashëri



# *Kombi ka nevojë për fenë*



Pothuajse në të gjitha sistemet e ngritura nga njerëzit ndër shekuj dhe që na i përcjell historia e faktuar, njerëzit kanë patur në thelb të tyre anën shpirtërore, kultin, fenë, qoftë si reflektim i drejtësisë, i pushtetit a qoftë si forcë e shoqërisë dhe jetës sociale, feja ka qenë ndër faktorët kryesorë që përbënte botëkuptimin e individit. Nuk mund të mendohet krijimi i një shoqërie të shëndoshë nëse në themelin e saj nuk mbrujtet besimi dhe feja, e cila siguron moralin, ndërgjegjen, tolerancën dhe parimet e virtutet e larta. Në të gjitha ato raste kur pushteti dhe shoqëria janë gjendur të kërcënuar nga zvetërimi, shthurja, korrupsioni dhe prishja morale, shkak kryesor është vërejtur të jetë çekuilibrimi i themelit individ-besim-moral.

Besimtari është ai individ që e sheh jetën e tij të pozicionuar sipas caktimit të Zotit. Kombi e gjuha amtare nuk zgjidhen, jepen, dhe këto nuk merren si të mirëqena, por vërehet se në shpirtin dhe zemrën e njeriut, kombi, atdheu, gjuha janë një esencë e zgjedhur prej Zotit si dhuratë ndaj njeriut të cilit pikërisht e krijoi prej dheut, i cili në fundin e jetës do t'i kthehet sërish dheut dhe jetën do ta sigurojë mbi këtë dhë. Kështu, as patriotët, as atdhetarët e tjerë nuk i zgjedhim, por jemi prej Zotit nga i njëjti dhë. Kështu formohen vlerat e përbashkëta dhe ruhen duke patur si princip binomin: vijmë prej Zotit. Mirëpo besimtari nuk mbetet në kufijtë e dheut dhe gjuhës apo kulturës së vet e të fqinjit bashkë, por zgjerohet përtej fqinjit, dhe sheh që dhe andej zgjatohet e zgjerohet po i njëjti dhë, po i njëjti lëmsh tokësor, e njëta botë, kësisoj e zgjeron zemrën e tij duke ujtur dashurinë e tolerancën për njerëzimin mbarë. Megjithatë, zembreku i tij mbetet te kombi që i dha Zoti. Tekefundit, ky ishte ngjyrimi që mori prej Zotit. Ajeti kuranor në suren Bekare cek pikërisht një anë të rëndësishme të kësaj që thamë, ku retorika e shprehisë na vë në dukje duke theksuar anën pozitive të disa çështjeve që shkojnë përtej vullnetit njerëzor: "E kush më mirë se sa Zoti jep ngjyrim?!"<sup>1</sup>

Zoti na bëri shqiptarë. Bij të këtyre trojeve. Kështu unifikohet në shpirtin e besimtarit atlas i gjerë i jetës. Në vegjëli, shqiptarin e mbështjell fanella e bardhë e djepit, më tutje mbi kryet e tij shndrit i bardhë plisi, a çallma, e po me të bardhë i jepet tokës, si një ravijëzim i siratit mustakim, e bardhë rruga: prej Zotit, për Zotin, për tek Zoti. E bardhë jeta, e bardhë vdekja. Trashëgimia e vlerave të ruajtura mardh mbi dokumentet dhe faksimilet e shumta të burrave të parë që firmosën deklaratën e pavarësisë, ku hoxhallarët ishin pishtarë të atdheut e njëkohësisht rojtarë të vlerave të përbashkëta.

Për t'i ruajtur këto vlera, këto nuanca shpirtërore të buruara prej fizikut dhe që zgjaten gjer në metafizikë, njeriu ka nevojë për një sistem që e lidh atë me gjenezën, me fillin fillestar të gjithçkaje, që është Zoti. Të parët i ruajtën ato vlera, pse kishin fenë, po të mos e kishin, nuk do mund t'i ruanin. Meqë në kohët e sotme nuk po arrijmë t'i ruajmë këto vlera të jashtëzakonshme të atdheut, kjo është ngaqë nuk ruajtën traditën e bukur të fesë, po ta kishim ruajtur, nuk do ta

katandisnim atdheun në djep të vuajtjeve e të pikëllimit.

Pikërisht, për këtë arsye Zoti ka dërguar profetë të cilët erdhën me një mesazh të qartë dhe me një sistem, një tërësi rregullash që i nevojiten njeriut për të siguruar fillimin-mbarëvajtjen-fundin, për të siguruar lumturinë në të dyja botët, ose thënë ndryshe, duke u ndërgjegjësuar për rrënjët e shpirtit, e më pas, të trupit, njeriu plotësohet në të gjitha dimensionet e nevojshme, dhe nuk ngec as në kufijtë e trupit, e as nuk mbetet në naivitetin e kufijve të brendshëm dhe të humbë koordinacionin gjeografik të tij. Por që të dyja bashkë. Fe dhe komb bashkë. Shpirt e trup bashkë. Po a nuk janë këto kushtet rrënjësore të jetës? Ç'ta bësh trupin pa shpirtin, apo anasjelltas?

Profeti Muhamed a.s. qe detyruar të migrojë nga vendi i tij i lindjes, Meka e shenjtë, për në Medinen e shndritshme. Rrugës, tëksa largohej dhe në sytë e tij tretej mbrapa atdheu, ai do të kthehej drejt Mekës dhe do të psherëtinte me këto fjalë që janë kuptimplota për zemrën e besimtarit atdhetar: "Nga gjërat që ka krijuar Allahu, ti je vendi më i dashur për mua! Po të mos më nxirrte populli yt prej zorit, kurrë nuk do të largohesha prej teje!"<sup>2</sup> Të dyja këto vende morën një rëndësi të jashtëzakonshme si shkak i ndërlidhjes që bëri migrimi i të dërguarit të Zotit a.s., dhe ende sot e kësaj dite, vizitorët e Mekës dhe Qabes që është në të, janë njëkohësisht vizitorë të Medines dhe Xhamisë së Profetit a.s., ku dhe gjendet vendprehja e trupit të tij në këtë botë.

Kështu, në këtë vazhdë, me këtë bosht ndienjash duhej të krijohet kombi dhe në fakt, ashtu ndodhi. Çdo gjë nisi nga vetja, që u përhap jashtë. Kështu na specifikon Kur'ani në një ajet të qartë: "**Vërtet Allahu nuk e ndryshon konditën e një kombi, derisa ata të ndryshojnë ç'kanë në vetvete (në nefset e tyre)**"<sup>3</sup>. Në vendin tonë, qenë pikërisht ata patriotë, atdhetarë, burra e gra të bashkuar mbi këto vlera që ndezën zjarrin e vatrës atdhetare dhe, të bërë bashkë ashtu me trup e me shpirt, plotësuan kombin shqiptar. Dhe nëse një ditë ne do të presim që sërish të lulëzojmë e te ngrihem prej hirit tonë e të jemi një komb me të cilin ne vetë krenohemi, por që të krenohen edhe ata bij e bija që janë larguar e kanë marrë udhët e mërgimit prej vitesh, kjo do të ndodhë vetëm atëherë kur rilindja, ndryshimi, rimëkëmbja do të nisë nga ndërgjegjja, morali, beimi dhe feja brenda individit që në vetvete, individ bashkë me familjen që krijon, përbën njësinë bazë të shoqërisë.

Lusim Zotin që ta ndriçojë këtë komb, ta bashkojë në të mirë dhe ta pastrojë nga e keqja e përcarjes dhe degradimit moralo-shpirtëror për hir të gjithë atyre shpirtëve të të parëve dhe lutjeve të tyre të shtrira përtej kohës ndër shekuj. E, për ta përmbyllur, citojmë këtu një nga thëniet e Haxhi Vehbi Dibrës, një nga burrat më të spikatur në radhët e para të Rilindjes, i cili thoshte: "*Armikut të atdheut i pritët hovi e guximi, në qoftë se na shef të bashkuar e të lidhur për një qëllim të naltë!*"

Mehmet Disha

2. Hejthemi, Mexhmeu'z-Zeuaid, 3/283

3. Kur'an, Ra'd, 13:11.

1. Kur'an, Bekare, 2:138.

# Dashuria dhe besnikëria ndaj atdheut virtyte të besimtarit



Jemi në festat e nëntorit dhe rrjedhimisht besimtari ka dëshirë t'i shikojë këto ngjarje edhe në këndvështrimin e besimit. Atdhedashuria është një ndjenjë e pastër shpirtërore që instinktivisht gjendet thellë në natyrën e çdo njeriu. Këtë lidhje e mbështetur në besnikëri, vet Zoti e ka mbjellë në trupin e njeriut, në gjenet e tij, në shpirtin e tij që kur e krijoi. Vendi ku u lind, ku lozi, ku u rritet me ushqimin dhe kulturën e tij, ku është njohur me të dashurit e tij, ku kalon vitet e jetës; sigurisht për njeriun ai vend bëhet shumë i dashur. Atdheu në radhë të parë, është pasuri që duhet ruajtur. E ajo pasuri është e gjithanshme, duke futur këtu familjen, gjuhën, traditën, kulturën etj.

Kur dashuria ndaj atdheut mishërohet me besimin në një Krijues, shfaqet në formën më të hijshme, duke sjellë vlera dhe dobi të gjithanshme. Parimi i parë dhe më themelor i fesë Islame, është që fjalët dhe veprat

e një personi, kurrsesi nuk duhet të tregojnë hipokrizi apo standarde të dyfishta. Besnikëria e vërtetë kërkon një lidhje të ndërtuar në bazat e sinqeritetit dhe ndershmerisë. Ajo kërkon që edhe nga brenda, njeriu të jetë i njëjtë me atë që shfaqet jashtë. Në marrëdhëniet me kombin, ky parim ka rëndësi të madhe. Prandaj, është thelbësore për një atdhetar të vendosë një lidhje besnikërie të çiltër ndaj atdheut të tij.

Deviza islame na mëson se dashuria ndaj atdheut është pjesë e besimit. Ndaj, patriotizmi i sinqertë është një kërkesë e Islamit. Njeriu që shprehet se e do atdheun e tij, është i pajisur me cilësi të larta morale, njerëzore dhe kombëtare. Ai duhet të përpiqet për atdheun e tij në të gjitha drejtimet sipas shkallës dhe nivelit të dijes dhe të pozitës. Dashuria ndaj atdheut kërkon prindër të mirë, të cilët i edukojnë fëmijët e tyre në rrugë të drejtë. Kërkon mësues të zellshëm, të cilët i mësojnë nxënësit në formën më të mirë të mundshme. Kërkon punëtorë administrate që u kryen shërbime qytetarëve me

korrektësi e gatishmëri. Kërkon hoxhallarë, të cilët përpiqen për ndërgjegjësimin e shoqërisë, duke i lidh njerëzit me fenë dhe atdheun e tyre. Kërkon politikanë, të cilët e përdorin postin për t'i shërbyer mirëqenies së popullit të vet. Kërkon tregtarë e biznesmenë të ndershëm, të cilët synojnë ta çojnë vendin përpara e ta zhvillojnë atë ekonomikisht. Kërkon gazetarë të mirë, të cilët mbrojnë vlerat e popullit dhe i përhapin ato. Kërkon policë e ushtarë vigjilentë që mbrojnë atdheun me dinjitet nga çdo e keqe e mundshme. Pra, dashuria ndaj atdheut kërkon një sensibilizim gjithë-popullorë, e cila nënkupton që interesi atdheut dhe i shoqërisë të jetë parësor dhe mbi interesat personale.

Në Islam, mbrojtja e atdheut me pasuri e me trup, është parim i fesë dhe numërohet respektivisht kontribut i shenjtë, i cili gradohet lartë dhe shpërblehet shumë nga Zoti (xh. sh.). Pikërisht për këtë, sipas mësimëve të islamit, shehidët-dëshmorët nuk vdesin. Dashuria e atdheut nuk është e barabartë tek të gjithë, ajo është shkallë-shkallë. Dikush është i flaktë në këtë drejtim, dikush është më i fortë, por më të këqij janë ata që nuk ndjejnë fare përgjegjësi për vendin e tyre, saqë arrijnë të vihen edhe në shërbim të të tjerëve, në dëm të interesave të kombit. Këta konsiderohen tradhtarë dhe do të dënohen si në këtë dynja, ashtu edhe në ditën e gjykimit, dënim i cili do të jetë shumë më i ashpër se i dynjasë.

Ata që nuk e duan atdheun e tyre, ata që punojnë për të keqen e popullit dhe të shoqërisë së vet, ata nuk i do as Zoti Fuqiplotë, siç ka theksuar në Kur'anin Famëlartë: **كَلِمَاتٍ لَا لِلَّهِ مُلْكُهَا يَوْمَ يَكْفُؤُا الْأُلَمُ** "Vërtet Allahu nuk i do tradhtarët" (Enfal, 8:58). Apo siç ka thënë Profeti Muhamed (a.s.). "Tradhtarët do të ringjallën ditën e Kiametit të dëshpëruar e të privuar nga mëshira e Zotit".

Islami gjithashtu, na mëson që në asnjë rrethanë, asnjë individ nuk duhet ta marrë vet ligjin në dorë dhe as nuk duhet të marrë pjesë në projekte dhe komplete kundër vendit të tij. Ky është një urdhër shumë i qartë që vjen nga Islami. Islami na mëson se njerëzit që ndjekin këto rrugë, nuk mund të shpresohet të tregojnë besnikëri, sepse besnikëria është e gërshetuar me virtytet e larta. Besnikëria nuk mund të ekzistojë pa vlerat e larta morale, dhe vlerat e larta morale nuk mund të ekzistojnë pa besnikëri. Besnikëria ndaj atdheut kërkon që njeriu të tregohet i virtutshëm, i duruar dhe zbatues i ligjeve të vendit. Prandaj, është e pamundur që dashuria e një myslimani ndaj Zotit, të mund të bëhet pengesë për të shprehur dashurinë dhe besnikërinë ndaj atdheut të tij.

Dashuria për atdheun është instinkt te njeriu. Është instinkt i mbjellë në shpirtin, e cila e bën njeriun të qetë kur qëndron aty dhe mallëngjehet për të kur është larg tij. Sado që njeriu të dëshirojë të largohet prej atdheut, dëshira për kthim mbetet përherë e varur në kujtesën e tij. Profeti Muhamed (a.s.) u detyrua të emigrojë nga Meka në Medinë. Një shenjë e dashurisë ndaj vendlindjes, ishte kur ai ktheu kokën edhe njëherë për të shikuar Meken dhe tha: "Sa vend i bukur që je, sa e dashur më je! Sikur populli yt të mos më nxirrnin me dhunë prej teje, kurrë nuk do të kisha banuar diku tjetër". (Buhariu)

Buhariu transmeton se kur një i ditur, Uereka b. Neufel, i tha Muhamedit (a.s.) se, në çastet e para të profetësisë populli yt do të torturojë, do të mendojë, do të bojkotojë, do të luftojë, do të tallë, do të shajë, do të largojë nga vendi, këtu Profeti ndaloi se i dhembti, dhe i çuditur pyeti: "Pse, a do të më nxjerrin me forcë?!" Uereka ia ktheu: "Po, nuk ka ardhë asnjë njeri me këtë që erdhe ti, e të mos jetë persekutuar. Nëse më zë dita jote, do të ndihmoj".

Ashtu siç donte Meken e nderuar, pas vendosjes në Medinë, tërë kontributin e tij, Profeti e kishte përqendruar në atdheun e dytë. E luste Allahun që ta pajisë me dashuri për të në këtë mënyrë: "O Allahu ynë! Na e bëj Medinën të dashur, ashtu siç e duam Meken, apo edhe më shumë." (Buhariu) Profeti ynë, aq shumë e donte Medinën, saqë kur dilte për ndonjë luftë apo udhëtim mallëngjehej shumë për të. Buhariu transmeton nga Enesi se kur Profeti Muhamed (a.s.) kthehej prej ndonjë udhëtimi dhe afrohej afër Medinës, aq sa shihte rrugët, pemët apo muret e saj, e nxiste devenë ose kalin të nxitonte. Kjo vinte pikërisht nga dashuria që ai ndiente për të.

Bazamenti i atdhetarizmit në Islam është besimi, e kurrësi fanatizmi racor apo kombëtar. Atdhetarizmin që Islami e refuzon është ai racor, grupor, i cili ummetin dëshiron ta ndajë në grupe të dobëta, që urrejnë njëra tjetrën dhe shajnë e fyejnë në vend që të ndihmohen e të përkrahen. Thotë Profeti Muhamed (a.s.): "Nuk është më i mirë arabi ndaj joarabit, përveçse me devotshmëri". (Ahmed)

Në këtë kohë, vërejmë që bota është bërë si një fshat global. Popujt e të gjitha kombeve, feve dhe kulturave gjenden në të gjitha shtetet. Kjo kërkon që liderët e çdo vendi të vlerësojnë dhe respektojnë ndjenjat dhe mendimet e të gjithë njerëzve. Padrejtësitë dhe egërsitë duhet të eliminohen dhe në vend të tyre duhet të mudohej për të vendosur drejtësinë e vërtetë. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë, është që bota të arrijë t'a njohë Krijuesin e saj. Çdo lloj besnikërie, duhet të lidhet me besnikërinë ndaj Zotit. Nëse do të ndodhë kjo, atëherë me sytë tanë do të mund të dëshmojmë tek njerëzit e të gjitha vendeve, nivelet më të larta të besnikërisë dhe do të hapen rrugët më të reja që na çojnë drejt paqes dhe sigurisë në mbarë botën.

Dashuria dhe besnikëria ndaj atdheut që pretendojmë, kërkon edhe sakrificë për të, kërkon kontribut të vazhdueshëm për t'i sjellë atij çdo të mirë dhe për të larguar prej tij çdo të keqe. Shqiptari e ka treguar dashurinë ndaj atdheut të vet brez pas brezi dhe ka përballuar shumë stuhi gjatë jetës së tij për liri. Shumë prej tyre kanë rënë në fushën e betejës dhe kanë marrë titullin e dëshmorit apo të shehidit. Besimtarët atdhedashës janë njëkohësisht edhe besimtarë besnik e të devotshëm, sepse nuk lejojnë që t'u preket feja dhe besimi i tyre, si dhe të merret nëpër këmbë atdheu.

Duke mbrojtur fenë islame, ne mbrojmë atdheun, sepse të mbrosh atdheun do të thotë të mbrosh dinjitetin tënd, të familjes tënde dhe atë kombëtare. Zoti na e shtoftë dashurinë dhe besnikërinë për atdheun.



# 1

## MBLIDHET KËSHILLI PËR ÇËSHTJE FETARE

Këshilli për Çështje Fetare, njësi pranë Institutit të Studimeve Islame “Hafiz Sabri Koçi” zhvilloi mbledhjen e parë për sezonin 2024-2025.

Në këtë takim mori pjesë edhe Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, i cili vlerësoi shërbimin e vazhdueshëm që ky këshill po ofron në trajtimin e çështjeve fetare të rëndësishme për besimtarët dhe shoqërinë shqiptare.

Pjesë kryesore e diskutimit ishin disa çështje të rëndësishme fetare me interes të gjerë në aktualitetin e shoqërisë tonë si: qasja e fesë islame ndaj abortit, surrogacisë, konsumimit të duhanit, ndërhyrjeve estetike, etj.

Përgjigjet dhe opinionet e këshillit mbi këto çështje do të publikohen herë pas here në faqen zyrtare të institutit, [www.insia.al](http://www.insia.al), nën seksionin e pyetjeve dhe përgjigjeve.

Këshilli për Çështje Fetare ka për qëllim trajtimin e çështjeve fetare me rëndësi për besimtarët myslimanë dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi. Këshilli ofron opinione teologjike dhe udhëzime praktike për pyetjet dhe nevojat e kohës.

Besimtarët dhe të interesuarit mund të dërgojnë pyetjet e tyre drejtpërdrejt në Këshill përmes kontakteve të mëposhtme për të marrë përgjigjen përkatëse në rrugë private brenda një kohe të shkurtër.

WhatsApp/Telegram: +355 69 544 12 99

E-mail: [insihsk@gmail.com](mailto:insihsk@gmail.com)







## 2

## INAGURUGOHEH MEDRESEJA E RE "MUSTAFA VAROSHI" DEGA DJEM, NË SHKOZET, DURRËS.

Në këtë aktivitet, ishin të pranishëm: H. Bujar Spahiu, Kryetar i Komunitetit Musliman të Shqipërisë, z. Adnan Al Gunejm, i Ngarkuari me Punë në Ambasadën e shtetit të Kuvajtit në vendin tonë, z. Korab Kaja, Drejtori i Fondacionit "Mirësia", përfaqësues nga Bashkia Durrës, Bashkia Shijak, përfaqësues të ndryshëm nga shoqata dhe shteti i Kuvajtit, myftinj të rretheve të ndryshme të vendit, imamë, drejtues organizatash, donatorë, prindër dhe mësues.

Pas leximit të disa ajeteve Ku'ranore, ceremonia u çel me fjalën përhëndetëse të Drejtorit të Fondacionit "Mirësia", fondacion ky i cili do të ketë nën administrimin e tij Medresesë e sapo hapur.

Në fjalën e tij, z. Kaja, ndau mesazhe të ndryshme falenderimi për të gjithë ata të cilët kanë kontribuar në plotësimin e binomit të medreseve "Mustafa Varoshi", tashmë edhe me degën e djemve. Më tej, ai i veçoi medresetë dhe projektet e financuara nga Kuvajti në Shqipëri, si një zë premtues për të ardhmen e shoqërisë shqiptare.

Më tej, të pranishmit e mbledhur me këtë rast i përhëndeti Kjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, i cili ndau me ta disa mesazhe frymëzuese për medresistët dhe rolin e tyre si liderë të devotshëm në të ardhmen profesionale të gjithësecilit.

Programi vijoi më tej me përhëndetjet nga të ftuarit e tjerë të nderit, të cilët ndanë mesazhe të shumta urimi, mbështetjeje, bashkëpunimi e falenderimi.

Në fund të kësaj ceremonie, u pre në mënyrë simbolike shiriti i inaugurimit dhe u vizituan ambientet e brendshme të medresesë së sapo hapur të djemve.





### 3

#### ÇELET FUSHATA E DHURIMIT TË GJAKUT NGA KMSH

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë çeli fushatën e dhurimit të gjakut në ndihmë të fëmijëve talasemikë.

E kthyer tashmë në një traditë disa vjeçare në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, kjo fushatë u zhvillua në ambientet e institucionit, ku përveç stafit, ju bashkëngjitën edhe qytetarë të ndryshëm.

Talasemia është një ndër sëmundjet më të shpeshta të gjakut, që ka përhapje masive edhe në Shqipëri, duke përfshirë më së shumti fëmijët.

Nevojat e tyre janë më të shumta se sa dhurimet vullnetare të gjakut në vendin tonë. Nisur nga kjo nevojë, kryetari i Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, nënshkroi edhe një marrëveshje bashkëpunimi me Sekretarin e Përgjithshëm të Kryqit të Kuq Shqiptar, z. Artur Katuçi për promovimin e dhurimit vullnetar dhe komponentëve të tij.

Nga kjo marrëveshje, KMSH do të sigurojë bashkëpunim dhe koordinim për zhvillimin e seancave të dhurimit të gjakut në myftinitë dhe xhamitë e vendit.

Allahu (xh.sh) i shpërbleftë të gjithë ata që dhuruan sot dhe që do t'i bashkohen kësaj thirrjeje edhe në vazhdim!





## 4

### MINISTRI I HAXHIT DHE I UMRES NË MBRETËRINË E ARABISË SAUDITE, SHKËLQESIA E TIJ, TAUFIK BIN FAUZAN AL-RABIAH, VIZITON VENDIN TONË

Ministri i Haxhit dhe i Umres në Mbretërinë e Arabisë Saudite, Shkëlqesia e Tij, Taufik bin Fauzan al-Rabiah, zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë me ftesë të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë (KMSH), H. Bujar Spahiu.

Qëllimi kryesor i vizitës ishte forcimi i marrëdhënieve mes dy institucioneve dhe avancimi i projekteve të përbashkëta që lehtësojnë dhe përmirësojnë përvojën e shqiptarëve që kryejnë ritualet e Haxhit dhe të Umres në vendet e shenjta.

Takimi i parë u zhvillua në ambientet e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ku Kryetari Spahiu, anëtarë të Kryesisë dhe myftinj i uruan mirëseardhjen Ministrit al-Rabiah dhe shprehën mirënjohjen për mbështetjen e palodhur të tij në përmirësimin e kushteve për pelegrinët shqiptarë.


Si pjesë e vizitës së tij, Ministri dhe Kryetari Spahiu udhëhoqën një takim pune me grupet përkatëse nga të dy institucionet, ku u diskutuan iniciativa konkrete për të zgjeruar bashkëpunimin.

Ky takim i përbashkët ishte një hap domethënës për të ndërtuar ura të reja bashkëpunimi, duke synuar që Shqipëria dhe Arabia Saudite të angazhohen më shumë në organizimin dhe mbështetjen e vizitorëve nga të dy vendet.

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm në axhendën e Ministrit al-Rabiah ishte vizita e tij në Panairin e Haxhit dhe të Umres, që u organizua për herë të parë në Ballkanin Perëndimor në bashkëpunim me KMSH-në.



# ROLI I PRIJËSVE MYSLIMANË NË FORMIMIN E SHETIT TË PARË SHQIPTAR



Shekulli XIX shënoi një epokë të re për popullin shqiptar, atë të Rilindjes. Ai hyri në historinë moderne të vendeve të Ballkanit si shekulli i lëvizjeve dhe revolucioneve kombëtare, që çuan në çlirimin dhe formimin e shteteve të pavarura. Për një varg rrethanash të brendshme e të jashtme, Shqipëria ishte vendi i fundit në Ballkan që u shkëput nga Perandoria Osmane dhe që shpalli pavarësinë kombëtare. Gjatë Rilindjes Kombëtare lindi dhe u zhvillua ideologjia e re kombëtare, e cila, duke u ngritur mbi ndarjet krahinore e fetare, shprehte aspiratat jo më të krahinave të veçanta, por të gjithë Shqipërisë dhe shqiptarëve si komb.<sup>1</sup>

Lëvizja Kombëtare Shqiptare për pavarësi dhe krijimi i shtetit shqiptar të pavarur, përbën një shembull mjaft domethënës të bashkëpunimit të sinqertë dhe pa asnjë paragjykim të intelektualëve dhe aktivistëve patriotë, të cilët, pavarësisht nga përkatësia fetare, dhanë një kontribut vendimtar për afirmimin politik e kulturor të kombit shqiptar. Të dhënat e përfutuara nga burime të ndryshme historike vërtetojnë qartësisht ekzistencën e tolerancës dhe të bashkëjetesës paqësore midis shqiptarëve të besimeve të ndryshme.

Periodha e Rilindjes Kombëtare, ajo e pavarësisë dhe e luftërave të ndryshme në mbrojtje të trojeve shqiptare, dëshmuar se ekzistenca e besimit fetar, jo vetëm që nuk u bë pengesë për përballimin e situatave të vështira të atyre kohëve, por shërbeu si faktor i domosdoshëm për ruajtjen e pavarësisë dhe forcimin e shtetit, duke u vlerësuar se diversiteti fetar ka qenë dhe është një pasuri kombëtare, kjo falë prijësve të shquar fetarë. Shumë kuvende e kryengritje lokale, krahinore, ndërkrahinore dhe mbarëkombëtare u udhëhoqën dhe u drejtuan nga klerikë të shquar shqiptarë. Një realitet ky, i cili herë pas here vlerësohet edhe nga opinioni ndërkombëtar.

Kur udhëton nëpër analet e historisë shqiptare dhe flet për lëvizjet dhe përpjekjet mbarëkombëtare, kupton se një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe rilindësit e mëdhenj shqiptarë, të cilët në shumë raste ishin drejtues fetarë, të cilët, në kushte dhe rrethana të ndryshme dhe shpeshherë mjaft të vështira, punuan për ngritjen e shtetit shqiptar, si dhe kontribuuan për forcimin dhe konsolidimin e tij.

Është e qartë që kleri mysliman ka dhënë një kontribut të veçantë për ekzistencën e popullit dhe të kombit shqiptar. Në përpjekjet dhe në luftën e gjatë për ruajtjen e identitetit kombëtar, ai ka marrë pjesë në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme. Mjafton të hedhim një sy me kujdes në të gjitha ngjarjet me karakter historik dhe politik dhe do vëmë re se prania e prijësve myslimanë është kudo

1. ASHSH, *Histori e Popullit Shqiptar*, Vëll. II, Toena, Tiranë 2002, f. 27.

e pashmangshme. Që nga kryengritjet kundër Tanzimatit me sheh Mustafën e sheh Fezën e deri te përfaqësimi në organizma si Komiteti i Stambollit, me Hoxha Hasan Tahsinin e madh, duke vazhduar me Daut efendi Boriçin, në Lidhjen e Prizrenit, me Hafiz Ibrahim Shkupin, në Kongresin e Manastirit, me Myfti Vehbi Dibrën, Hafiz Ali Korçën dhe Ismail Efendi Ndroqin në Kongresin e Dibrës, me Myfti Vehbi Dibrën e Sheh Ahmet Pazarin në shpalljen e Pavarësisë më 1912 dhe ngritjen e flamurit, etj.

Pra, në gjithë rrjedhën e ngjarjeve që përcaktojnë fatin e Shqipërisë e të shqiptarëve, pa dyshim, gjen edhe ata, krerët e besimit mysliman, krah për krah, dorë për dorë e gojë për gojë me të gjithë klerikët e besimeve të tjera në Shqipëri.

Ngjarje të rëndësishme mbarëkombëtare janë të lidhura me zhvillimin e tyre pranë institucioneve fetare gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare si për shembull, Lidhja Shqiptare e Prizrenit u ndez në Medresenë e Xhamisë Bajrakli. Kryetari i saj pas Iljaz pashë Dibrës, u zgjodh kleriku Haxhi Ymer Prizreni, që ishte dhe kryeministri i parë shqiptar në Qeverinë e përkohshme të Lidhjes. Ishin klerikët ata që kontribuuan së bashku me personalitete të shquara të vendit, për hapjen e mësonjëtove të para në gjuhën shqipe dhe për t'u mësuar fëmijëve shkrimin e këndimin e shqipes, si Hoxha Tahsini, Said Najdeni, Vehbi Dibra (Agolli), Hafiz Ali Korça, etj.

Gjatë viteve 1900-1912, ata i gjejmë të pranishëm në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme të jetës politike, social-arsimore të vendit tonë, në kuvende dhe kongrese mbarëkombëtare si: Kuvendi i Pejës, i drejtuar nga kleriku Haxhi Zeka, kongreset arsimore të Manastirit e Ebasanit, në Kongresin e Dibrës të 23 korrikut 1909, të drejtuar nga Vehbi Dibra, në kuvendin e madh të Vlorës etj. Me mendimin dhe qëndrimin e mbajtur, klerikët shqiptarë luajtën rol të rëndësishëm në orientimin kombëtar të tërë jetës së vendit tonë. Në gjirin e kësaj lëvizje të gjerë politike, arsimore dhe ushtarake, ata bashkëvepruan dhe me figura të rëndësishme të lëvizjes sonë kombëtare, Ismail Qemalin, Isa Boletinin, Hasan Prishtinën, Luigj Gurakuqin, etj.

Në kuvendin e Pejës dhe të Dibrës të vitit 1899, Haxhi Zeka, Selim Rusi, Vehbi Dibra, Myfti Saliu, Myderiz Ismaili, Myderiz Abdullahu etj., luajtën një rol të rëndësishëm, duke dhënë një shembull se si duhej të zgjidhej çështja kombëtare. Klerikët jo vetëm ishin përfaqësues të krahinave të ndryshme shqiptare në këto kuvende, por dhe figura me shumë reputacion në delegatët e tjerë pjesëmarrës të këtij kuvendi. Fjala e tyre zinte vend sa herë që shprehej.

Përhapja e shkollave dhe e mësimit të gjuhës shqipe, si dhe zhvillimi i kulturës kombëtare, shtruan

nevojën e caktimit të alfabetit të gjuhës shqipe. Për këtë u organizua Kongresi i Manastirit më 14 nëntor 1908. Delegatët e kongresit ishin shkrimtarët dhe publicistët më të njohur, lëvrues të gjuhës shqipe, laikë e klerikë si: Vehbi Dibra, Haziz Ibrahim efendi etj., shtruan domosdoshmërinë e caktimit të një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe.<sup>2</sup> Në këtë kongres klerikët mbështetën idenë për përdorimin e një alfabeti të ri të gjuhës shqipe me germa latine dhe për mësimin e shqipes në shkollat e Shqipërisë.<sup>3</sup>

Në Kongresin e Dibrës, Vehbi efendi Dibra, Hafiz Ali Korça, Haxhi Hafiz Ibrahim efendi, Hafiz Sherif Lëngu, etj., do të krijonin klube shqiptare e do të viheshin në krye të luftës kundër xhonturqve, që përpiqeshin të pengonin zhvillimin e kombit shqiptar, bashkimin e tij. Në Kongresin e Dibrës, Vehbi Dibra, për aktivitetin e tij fetar dhe politik, do të zgjidhej kryetar i Kongresit. Ky kongres i kalonte caqet kombëtare, gjë që tregohet nga pjesëmarrja e delegatëve laikë e klerikë jo vetëm nga vilajetet e Selanikut, Manastirit, Janinës, Kosovës dhe Shkodrës, por dhe e përfaqësuesve serbë, grekë, bullgarë e vllah. Ky ishte i pari kongres ku më tepër se 300 delegatë toskë, gegë, myslimanë, ortodoksë, katolikë, priftërinj, hoxhallarë e shehelerë u konvertuan në një pikë, shkëputjen e Shqipërisë nga Turqia dhe arritjen e pavarësisë kombëtare.

Atdhetarët Hafiz Ali Korça, Abdyl Ypi, Kenan Manastirli, Vehbi Agolli, Haxhi Ali Elbasani, etj., e bënë Kongresin e Dibrës arenë të luftës dhe shpalosjes së mendimit e kërkesave të mirëfillta të shqiptarëve, kërkesa që ishin nga më të avancuarat të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Si rezultat i kësaj lufte, kongresi punimet e tij i nisi dhe i përfundoi si një kongres shqiptar, si një kongres që trajtoi dhe shumë probleme të rëndësishme kombëtare që dilnin dhe jashtë kompetencave të rendit të ditës. Në të u ngritën probleme me kërkesa të mirëfillta shqiptare ku u shfaqën hapur:

- kërkesat me karakter të theksuar politik kombëtar, që çonin drejt realizimit të autonomisë së Shqipërisë,

- kërkesat për hapjen e shkollave shqipe të mbrojtura nga shteti,

- futjen e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore,

- çështjen e alfabetit, etj.<sup>4</sup>

Punimet e Kongresit, lufta e ashpër politike që u zhvillua aty, provuan plotësisht se kërkesat e delegatëve patriotë ishin një përpjekje e hapur për

2. ASHSH, *Histori e Popullit Shqiptar*, Vëll. II, Toena, Tiranë 2002, f. 392.

3. Prof. dr. Qazim Xhelili, Monografi, "Vehbi Dibra", Tiranë: Albin 1998, f. 27.

4. Gazmend Shpuza, "Kongresi kombëtar i Dibrës 1909", Dibër 2005, f. 32.

realizimin e autonomisë së Shqipërisë. Kërkesa të tilla si ajo që nëpunësit e administratës vendase të dinin gjuhën dhe zakonet e vendit, futja e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore, hapja e shkollave në gjuhën shqipe, kryerja e shërbimit ushtarak në vend, përdorimi dy gjuhësh në dokumentat përfundimtare të tij, janë arritjet më të mëdha të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, suksese që nuk ishin arritur në kongreset e tjera kombëtare.<sup>5</sup>

Në Kongresin e Elbasanit të 2 shtatorit 1909, prijësit myslimanë Hafiz Ibrahim Dalliu, Josi Haxhi Mima, Emin Haxhi Ademi dhe Hoxhë Muglica, bënë gjithçka për të hapur Normalen e Elbasanit, përkrah Luigj Gurakuqit, Hamdi Ohrit, Dervish bej Biçakut, Mit'hat Frashërit dhe të tjerëve.

Elita fetare e vendit ka meritat më të para nga të gjitha elitat e tjera. Në rast se vështrojmë kombet dhe historitë e tjera do të gjeni kombe të cilat kanë tradita mijërvjeçare shkrimi, alfabetesh, bibliotekash, librash dhe qytetërimi. Por, kombi ynë ka një specifikë që nuk e ka asnjë komb tjetër, që është diamant i qytetërimit të kombeve, kjo është bashkëjetesa fetare. S'ka dhe s'mund të ketë asnjë tregues më epror për qytetarinë e një kombi sesa harmonia fetare.

Shqipëria përgjatë historisë së saj ka qenë një shembull se si njerëzit e fesë kanë ditur të zgjidhin saktë marrëdhëniet e besimit me kombin. Një mori dijetarësh shqiptarë të profilit fetar mysliman, katolik apo ortodoks kanë dhënë kontribut të çmuar në të gjitha fazat zhvillimore dhe format organizative të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Prijësit myslimanë, duke ruajtur harmoninë fetare, janë përpjekur në të gjitha mënyrat vetëm për një shoqëri me parime patriotike, për një shoqëri bashkëkohore, për forcimin e ndërgjegjes kombëtare, dashurisë për gjuhën dhe traditat shqiptare, dashurisë për atdheun e dashurisë për njëri-tjetrin. Më në veçanti kjo vepër bën ekzaminimin e përpjekjeve madhore të dijetarëve myslimanë, që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri në pavarësinë e Shqipërisë, jo vetëm për çlirim kombëtar, jo vetëm për arsimin e shkollat shqipe, por krijimin e shtetit shqiptar. Me firmën jo vetëm të patriotëve shqiptarë, por dhe të klerikëve myslimanë, si: Hafiz Ismet Dibra, Vehbi Dibra, Hafiz Sherif Lëngu, etj., Shqipëria të shpallej e pavarur.<sup>6</sup>

Pavarësia e Shqipërisë ishte aspiratë dhe punë atdhetare e një kombi të tërë nga gjiri i të cilit lindën shumë heronj. Midis tyre historiografia jonë duhet të nënvizojë fort emrat e klerikëve myslimanë, njerëz me shumë reputacion në mbarë Shqipërinë, të aftë,

5. Manastirli Kenan, "Kongresi i Dibrës", Stamboll, 1912, f. 7.

6. Kamberi Mois, "Dibra në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare", Maluka, Tiranë, 2012, f. 176.

largpamës, me nuhatje e drejtpeshim politik.<sup>7</sup>

Kulmin e ngritjes së tyre jo vetëm si klerikë, por dhe si luftëtarë të çështjes kombëtare, ata do ta arrijnë me pjesëmarrjen në Kuvendin e Vlorës dhe zgjedhjen e tyre në organet më të larta të Qeverisë së Përkohshme.

Në situatën e krijuar, kur forcat ballkanike po pushtonin Shqipërinë dhe trevat shqiptare rrezikoheshin nga një copëtim i ri, rrethet atdhetare shqiptare brenda dhe jashtë atdheut arritën në përfundimin se e vetmja rrugë për shpëtimin e Shqipërisë ishte shpallja e Pavarësisë. Për këtë qëllim do të organizonin një kuvend mbarëkombëtar, ku do të mernin pjesë delegatë të zgjedhur nga të gjitha krahinat shqiptare.

Telegrame të shumta të dërguara nga Vlora për Prefekturën e Elbasanit tregonin interesin e veçantë që kishin organizatorët e kuvendit për arritjen në Kuvendin e Madh të përfaqësuesve të klerikëve myslimanë, si: Vehbi Agolli (Dibra) dhe Hafiz Sherif Lëngu,<sup>8</sup> personalitete me kontribut fetar e politik të gjithanshëm për çështjen kombëtare, mandate që ua ngarkonte mbarë popullsia e Dibrës dhe e krahinave përreth për të dërguar fjalën e tyre në Kuvendin Kombëtar në Vlorë.

Për të plotësuar këtë detyrë të vështirë, mbledhjen e Kuvendit Kombëtar, më 21 nëntor 1912, Ismail Qemali arriti në Durrës. Plaku i urtë Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi e atdhetarë të tjerë të shoqëruar nga Nikoll Kaçorri u nisën për në Vlorë.<sup>9</sup>

Më 21 nëntor 1912, Isa Boletini, Ajdin bej Draga, Mehmet pashë Dërralla dhe delegatët e zgjedhur të Dibrës, Vehbi Agolli dhe Hafiz Sherif Lëngu, u nisën nga Dibra për në Elbasan,<sup>10</sup> ku i prisnin delegatët e kësaj treve për të shkuar së bashku drejt Vlorës.<sup>11</sup>

Ndërsa delegatë nga të gjitha krahinat e tjera shqiptare grupoheshin dhe së bashku niseshin për në Vlorë, qyteteve shqiptare që rrezikoheshin nga pushtimi i shteteve fqinje, iu kërkua që ta ngrinin sa më shpejt flamurin kombëtar, me qëllim që pushtuesi i ri t'i gjente të pavarura. Midis 37 delegatëve<sup>12</sup> dalloheshin klerikët Vehbi Agolli, Hafiz Sherif Lëngu dhe Dom Nikoll Kaçorri.

Përballë kërcënimit të ri të pushtimit nga ushtritë ballkanike dhe situatës së re të krijuar për trevat shqiptare, Ismail Qemali dhe atdhetarë të tjerë të mbledhur në Vlorë, hapën më 28 nëntor 1912, ora

14.00, punimet e Kuvendit Kombëtar për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, pa pritur ende të gjithë delegatët e krahinave shqiptare për shkak të vështirësive të mëdha që ekzistonin. Mendimi i klerikëve për Pavarësinë e Shqipërisë u mbështet nga të gjithë delegatët me në krye Ismail Qemalin, të cilët e shpallën Shqipërinë shtet të pavarur: "Shqipëria më sot të bëhet më vehte, e lirë e mosvarme".<sup>13</sup>

Pas shpalljes së pavarësisë, përpara kuvendit kombëtar shtroheshin detyra të reja historike: të ngrihej shteti i pavarur shqiptar me administratën dhe forcat e tij të armatosura, të sigurohej njohja ndërkombëtare e pavarësisë dhe e kufijve politikë shtetërorë, që të përfshiheshin të gjitha trojet etnike shqiptare, të shtrihej pushteti shtetëror në këto troje dhe të organizohej mëkëmbja dhe zhvillimi ekonomik i vendit.

Ismail Qemali i paraqiti Kuvendit dhe ia besoi atij zgjedhjen e anëtarëve të qeverisë. Rrjedhimisht anëtarët e saj duhet të ishin të njohur brenda dhe jashtë vendit. Më 4 dhjetor 1912, u zgjodh Qeveria e Përkohshme.<sup>14</sup> Në përbërjen e këtij kabineti qeveritar spikasnin krahas figurave të tjera atdhetare Myfit bej Libohova, Abdi bej Toptani, Mehmet pashë Deralla, Petro Poga, Luigj Gurakuqi, Mithat Frashëri, Pandeli Cale, Les Nosi dhe figurat e dy klerikëve Dom Nikoll Kaçori dhe Vehbi Agolli.

Me propozim të Ismail Qemalit, në Kuvend u zgjodhën dhe organet më të larta të përfaqësimit të qeverisë shqiptare. Në mbledhjen e dytë, që u hap më 30 nëntor 1912, me propozim të Luigj Gurakuqit, Vehbi Agolli u propozua të zgjidhej kryetari i Pleqësisë shqiptare (senatit). Më 4 dhjetor 1912, Kuvendi i Vlorës zgjodhi jo vetëm Qeverinë e Përkohshme, por dhe Pleqësinë prej 18 anëtarësh. Kryetar i pleqësisë u zgjodh Vehbi Dibra.<sup>15</sup> Në Kuvendin e Vlorës, Vehbi Agolli bëri dhe betimin e flamurit dhe dha Fet'fanë për shpalljen e pavarësisë. Kjo qe zgjedhja e dytë e një atdhetari klerikal në postet më të larta të qeverisjes pas zgjedhjes së Dom Nikoll Kaçorrit si nënkryetar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Ndërkohë që Ismail Qemali merrej me zgjidhjet diplomatike të shtetit shqiptar jashtë atdheut, aktivitetin brenda tij e ushtronte Vehbi Dibra, mjaft i sukseshëm në shtrirjen e autoritetit të shtetit të parë shqiptar në të gjitha trevat shqiptare.

7. M. H. D. Fondi Dosje Patriotësh, *Vehbi Dibra*, dosja, nr. 598.

8. A.Q.SH. - Fondi 71, D 1, Përkthim nga turqishtja.

9. Zani i Naltë, viti 1937.

10. A.Q.SH. - Fondi - 245, D. 2, f. 6, viti 1912.

11. A.Q.SH. - Fondi 32, D. 26, f. 133.

12. Valentina Duka - "Histori e Shqipërisë 1912-2000", Tiranë: Shblu, 2007, f. 19.

13. *Histori e Popullit Shqiptar*, Vëll. II, Tiranë: Toena 2002, f. 511.

14. Xhafa Bajram, "Historia e Shqipërisë, periudha e pavarësisë", Shkodër, 2006, f. 16.

15. Valentina Duka, "Histori e Shqipërisë 1912-2000", Tiranë: Shblu, 2007, f. 24.

# Gjuha shqipe dhe shtetformimi në veprat e dijetarëve islam



*Kontributi i dijetarëve islam për gjuhën shqipe dhe shtetformimin përbëjnë një fushë studimi me interes, që kanë tërhequr vëmendjen dhe janë bërë objekt kërkimesh e hulumtimesh nga shumë studiues gjatë viteve. Një përpjekje e tillë e dijetarëve islam shënon fillimin e një reforme të madhe në ngritjen e kulturës kombëtare dhe përhapjen e kulturës islame në gjuhën amtare. Përveç, kësaj dijetarët islam në planin politik gjithnjë punojnë në mbarëvajtjen e kombit e të atdheut.*

Historia shkruhet sipas logjikës së fakteve dhe mbetet një libër i hapur për të gjitha kohërat. Pikërisht kjo, pra historia, respekti dhe mirënjohja që vendet e qytetëruara ju kanë dhënë ndër shekuj njerëzve të shquar të kombit në kulturë art dhe shkencë, nëpërmjet të cilëve kanë krijuar edhe identitetin e tyre, ka bërë që gjithmonë të mbeten në pedestal.

Kështu, dijetarët islam, apo siç i quajmë ndryshe me fjalorin oriental ulematë janë dëshmuar si krijues dhe ithtarë të denjë të lëvizjes mendore e iluministe dhe veprimtarë të denjë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Veprimtaria e pasur e shumë dijetarëve islam, e gërshetuar me motivin patriotik dhe fetar ka bërë që të vlerësohet lart mudi dhe sakrifica e tyre për një shtet të fuqishëm dhe kompakt. Ide kjo e ngritur dhe e ngulitur në vetëdijen kombëtare e fetare nga rilindësit tanë. Një bashkëveprim i tillë bëhej vetëm nga ata të cilët kishin ndërtuar bindjen se ne shqiptarët mund të qëndrojmë të fortë në tri vertikale<sup>1</sup> - që kishin të përbashkët vetëdijen kombëtare shqiptare.

Dijetarët islam jetuan në një epokë krizash, lëvizjesh e

1. M. Hysa, Alamiada shqiptare I, Shkup, f. 10.

përmbysjesh të mëdha, në një epokë ballafaqimesh të ashpra politike, ekonomike e ideologjike. Të gjitha këto i përjetuan në mënyrën e vet, duke mbetur kurdoherë në pozitat e një krijuesi të denjë, por edhe të një pjesëmarrësi të drejtpërdrejtë në betejat e luftës. Afërsia e tyre me qytetërimin evropian, por edhe me atë të lindjes ju mundësoi atyre të pasurohen intelektualisht dhe të përfitojnë nga këto dy kultura duke u bërë edhe pjesë e tyre.

Veprimet e tilla të sunduesve të huaj bënë që nga gjiri i popullit të dalin mendimtarë, historianë, gjuhëtarë e artistë, veprat e të cilëve do të lënë gjurmë në zhvillimin e ndërtimin e shtetit.

## **Veprimtaria kombëtare e shkencore e dijetarëve islam**

Kufizimi i të drejtës elementare, përdorimit të gjuhës amtare shqipe bëri që të gjithë së bashku myslimanë, katolikë e ortodoksë shqiptarë të ndjehen keq për një privim të tillë, gjë që përforcoi edhe më shumë unitetin e tyre kombëtar shqiptar me moton se atdheu duhet çliruar. Të shkruarit në gjuhën shqipe përfaqësonte një simbol të qëndresës ndaj të gjithë atyre që përbuznin gjuhën shqipe.

Të gjitha lëvizjet kombëtare bartin me vete emra të shquar të kombit, krijues të fjalës së shkruar, të cilët sot e kësaj dite gjenden në pedestal. Kështu mund të themi se sot si krijues janë të njohur Mulla Hysen Dobraci dhe Mulla Sali Pata, të cilët një mbledhës i shquar i folklorit shqiptar Zef Jubani, njërin, Mulla Hysen Dobracin do ta quaj edhe si "Anakreonti i Shqipërisë", ndërsa Mulla Sali Patën do ta quaj patriot me vetëdije të qartë kombëtare. Të tillë dijetarë - teologj janë të shumtë, ndër ta është edhe Seh Jonuzi



(1848 – 1909) një hoxhë i shquar, i shkolluar në Stamboll, i cili tërë veprimtarinë e vet do t'ia kushtojë gjuhës dhe shkollës shqipe, për çka do të nxirret edhe para gjyqit në Shkup. Ndërkaq, Dervish Salihu në poezinë e tij Bismil-lahi nuk e nisa mbështet kërkesat dhe aspiratat e lidhjes. Baba Meleqi, ku temë kryesore në poezinë e tij është kushtrimi për atdhenë. Ai përmes vargjeve fton popullin të rrëmbejnë armët kundër sunduesve barbarë Rrëmbeni pushkën dhe pallël. Në këtë periudhë të Lëvizjes Kombëtare, me pikëpamje fetare e kombëtare vepruan edhe Rexhep Voka e Said Najdeni, veprimtarë të shquar të Lëvizjes Kombëtare. Janë këta dy emra që përcaktojnë qartë jo vetëm vetëdijen kombëtare, por edhe atë fetare duke himnizuar se jemi vëllezër të krishterë e mysliman, ashtu si toskë e gegë, të cilët do të japin një kontribut të çmueshëm në kultivimin e dijes në gjuhën kombëtare shqipe. Kështu, kontributi i çmuar që do të jap Rexhep Voka për shtetin shqiptar, duket qartë edhe në ngritjen e dijes, me ç'rast vë në spikamë nevojën e shkrim-leximit shqip. Ai më 1910 do të hartojë një abetare shqipe me shkronja arabe, por të përshtatur me fonetikën shqipe, të cilën e titulloi "Abbeja skip". Një vit më vonë, më 1911, R. Voka boton "Gramatikën elementare shqipe", si edhe një tekst mësimor fetar "Ilmihali i hollësishëm shqip", në të cilin shpjegohen rregullat e besimit islam. Ndërkaq, Said Najdeni, i cili i frymëzuar nga Lëvizja Kombëtare Shqiptare dhe takimi me atdhetarë të shquar bëri që më 1888 të hapë shkollën shqipe në Dibër. Veprat kryesore që S. Najdeni botoi me alfabetin latin janë dy. E para është "Fe rrëfënjësja e myslimanëve", botuar në Sofje më 1900, dhe e dyta "Abetare e gjuhës shqipe ndë të folë gegënisht", botuar po në Sofje më 1900, në mënyrë anonime. Veprimtaria kombëtare e fetare e dijetarëve islam lë gjurmë të pashlyeshme në të gjitha poret e jetës kombëtare e fetare shqiptare. Për një veprimtar të tillë u shqua edhe Haxhi Vehbi Dibra, delegat i Kuvendit historik të Vlorës të udhëhequr nga Ismail Qemali, një komentator i shquar i Kur'anit në gjuhën shqipe.

Një kontribut të tillë të madh për kombin, shtetin dhe gjuhën e dëshmojnë shumë atdhetarë të shquar, "Çohu prej gjumit more vlla", "Mos e le udhën, o insan", "Fjalim shqip a than", thoshte Vejsel Xh. Guta, mejtepi i të cilit gjatë viteve 1941-1945 u bë shkollë kombëtare-fetare, ku në mënyrë ilegale përveç lëndëve fetare, zhvilloheshin edhe lëndë të tjera si: matematika, astronomia, gjeografia dhe historia.

#### **Publicistika**

Shoqëritë shqiptare të themeluara nga rilindësit tanë në shumë vende të botës ndihmuan në mbajtjen gjallë të vetëdijes kombëtare shqiptare, kështu shoqëria "Drita" e themeluar nga Mulla Rexhepi kishte në programin e saj gjuhën shqipe, ruajtjen dhe mbledhjen e pasurisë gojore shqiptare. Mulla Rexhepi në derset (mësimet) e tij të zjarrta luftonte haptas shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi, strategji kjo e ndërtuar dhe e zbatuar me vite nga sllavët. Po kështu veproi edhe Ferit Vokopola, i cili më 28

Nëntor 1912 firmosi dokumentin e Shpalljes së Pavarësisë si delegat i Vlorës. F. Vokopola njihet edhe si themelues organizatës fetare "Drita Hyjnore", që pati si organ të vetin revistën "Njeriu", e cila doli rregullisht nga korriku 1942 deri në qershor 1944. Ai i cili do t'i dhurojë lexuesit shqiptar Kur'anin e përkthyer në gjuhën shqipe është edhe veprimtari dhe përkthyesi i njohur Hasan Efendi Nahi. Me një veprimtari të tillë të përkthimit dhe publicistike shquhet edhe Haki Sarofi, nxënës i Normales së Elbasanit dhe ndër themeluesit e revistës "Zani i Naltë", të cilën edhe do ta udhëheqë gjatë viteve 1930-1939.

#### **Për iman e vatan**

Shumëkush praninë e tri besimeve e shihte si shkas për një konflikt me përmasa të mëdha, gjë që nuk ndodhi asnjëherë, por të gjitha këto përbënin një faktor që luajti rol në zhvillimin kulturor të vendit. Të gjithë këta, pa dallim feje ishin vetëdija më e zgjuar e kombit, të prirë nga qëndrimi kritik ndaj dukurive dhe fenomeneve shoqërore e politike, nuk pajtohen me realitetin e hidhur dhe i kundërvihen atij me tërë forcën e fjalën artistike, duke kërkuar raporte të reja, më të shëndosha, më të pranueshme. Kështu, Petro Nini Luarasi, ndër mësuësit e parë të shqipes do të jepte urdhër që në shtëpinë e tij të mos gatuhet mish derri, se vijnë vëllezërit mysliman. Ai do të shkojë edhe më larg duke e pagëzuar të birin me emrin Skënder. Përveç kësaj, Hafëz Ibrahim Efendi i emocionuar nga fjalimi i At Gjergj Fishtës, me vrap kishte vajtur drejt tribunës, përzemërsisht e me lot në sy kishte përqaftuar at Gjergj Fishtën. Po kështu, Gjergj Fishta, duke e parë rrezikun nga fqinjët, te kryevepra e tij "Lahuta e Malcis" u drejtohet shqiptarëve: "Por, pse na të vogjël jemi/Pse fis e vlla nuk kemi/Na sod shkjaut s'mund t'i bajmë ballë/Qi po do t'na përpijë gjallë,/Prandej, thom se e lyp e mara/Qi dhe sot na, si përpara,/Të rrim njit me mbret t'Stambollit/Për me i bamun ballë Nikollit..." Poeti i madh i kombit, prifti i lartë i Kishës Katolike, Gjergj Fishta, vetë e shikonte Mbretin, Sulltanin, Turqinë, Stambollin, në atë periudhë të vështirë për shqiptarët dhe trojet e tyre, si shpëtimtar dhe si një faktor i bashkimit kombëtar, përballë fqinjëve serbo-malazez. Uniteti kombëtar, pa dallim feje është kushtrim edhe i Haxhi Vehbi Dibrës, i cili në bashkimin e të gjithë shqiptarëve shihte të vetmen rrugë për të siguruar të ardhmen tonë. Ai do të thoshte në Kuvendin Kombëtar të Vlorës më 28 nëntor 1912 se "Kristiani e myslimani janë vëllezër shqiptarë të pandarë". "Armikut të atdheut i pritët hovi e guximi në qoftë se na shef të bashkuar e të lidhur për një qëllim të naltë".

#### **Rezyme**

Të gjitha lëvizjet kombëtare bartin me vete emra të shquar të kombit, krijues të fjalës së shkruar, të cilët sot e kësaj dite gjenden në pedestal. Kështu, një inteligjencë e pajisur me kulturë orientale, përkatësisht me orientim fetar islam jo vetëm që ndihmuan në ndërtimin dhe konsolidimin e shtetit, por ndihmuan edhe në ngritjen kulturore të popullit me hapjen e shkollave, botimin e revistave e kështu me radhë.

# *DROPSHIPPING* KËNDVËSHTRIMIN ISLAM

Dropshipping është një model biznesi në të cilin një dyqan online nuk mban fizikisht stok të mallrave që shet. Ai thjesht shfaq në një faqe online fotografitë dhe informacionet e produkteve që ofron. Kur dyqani online merr një porosi nga një klient, ai blen produktin nga një furnizues, i cili e dërgon produktin direkt te klienti. Shitësi online vendos një çmim më të lartë sesa ai i furnizuesit dhe në këtë mënyrë siguron fitimin e vet.

Tregtia në Islam është e lejuar, por ka disa pika që duhen pasur parasysh në mënyrë që mos të rrezikohet e drejta e askujt. Dropshipping ka disa pika të diskutueshme nga ana fetare:

– Problemi i pronësisë: Shitësi online po shet diçka që nuk e posedon. Profeti (a.s) ka thënë: “Mos shit atë që nuk e zotëron” (Ebu Daud, 3503). Në literaturën juridike kjo është quajtur “bej’ul ma’dum” (shitja e inekzistentes). Bazuar në këtë hadith juristët janë shprehur se është e ndaluar shitja e produkteve që shitësi nuk ka në pronësi, e atyre që s’ka marrë në dorëzim apo që s’ka detyrim t’i dëmshpërblejë. Në parim personi mund të shesë produktin që ka blerë më parë dhe që e ka marrë në dorëzim. Por në dropshipping shitësi online shet një produkt që nuk e ka në zotërim.

– Dy kontrata: Nga aspekti të drejtës islame në dropshipping bëhet fjalë për dy kontrata. E para është mes shitësit online dhe blerësit, e dyta është mes shitësit online dhe furnizuesit. Në të drejtën islame kontrata quhet e realizuar në momentin, që palët i dorëzojnë njëri-tjetrit pagesën dhe produktin. Në rastin e dropshipping, duke pasur dy kontrata, duhet të realizohen edhe nga dy dorëzime. Por ndërkohë që bëhen dy pagesa, ndodh vetëm me një dorëzim i produktit. Ai nga furnizuesi tek

blerësi fillestar.

– Garari dhe transparenca: Ligji islam thekson transparencën dhe shmangien e garar-it (pasigurisë) në transaksione. Në këtë rast garari është pasiguria në ekzistencën e produktit në momentin e kontratës, pra në momentin e aktit të blerjes online. Nëse shitësi komunikon qartë kohën e dorëzimit, specifikimet e produktit dhe politikën e kthimit, atëherë kjo mund të zbusë shqetësimet në fjalë.

– Problematika të tjera: Përveç këtyre ka edhe çështje të tjera problematike, që ndryshojnë nga një shtet në një tjetër, si fakti që pagesa e bërë prej blerësit në shumë raste është e aksesueshme pas një farë kohe, p.sh., pas 15 ditësh; përdorimi i servisit të furnizuesit për shitësin online pa i vënë në dijeni, rritja e çmimit të tregut në mënyrë artificiale, dhe shumë forma të tjera të hapura për abuzim.

## ZGJIDHJE TË MUNDSHME

Shitjet që përmbajnë problematikat e mësipërme, edhe sikur të realizohen praktikisht, nga ana fetare, ku më pak e ku më shumë, janë problematike dhe në shumë raste të ndaluara. Dijetarët kanë vendosur disa kushte për lejueshmërinë e këtij aktiviteti, duke ofruar këto zgjidhje:

### 1 – Kontratë mes shitësit online dhe furnizuesit

– Për të shmangur problematikën e pronësisë, shitësi online mund të bëjë një kontratë me furnizuesin për të gjitha produktet që do të ofrojë online. Në këtë mënyrë ai konsiderohet një filial online i furnizuesit dhe ka të drejtë ta shesë produktin në çmimin që përcakton vetë.

– Në rast të një kontrate të tillë zgjidhet edhe çështja e dorëzimit të drejtpërdrejtë nga furnizuesi, sepse konsiderohet pjesë e shërbimit që ofron i njëjti dyqan.

– Shfaqja në internet e tipareve të nevojshme për identifikimin e saktë të produktit bashkuar me kontratën e filialit zbut problematikën e gararit.

## **2 – Kontratë pa detyrime, autorizim**

– Nëse marrëveshja mes blerësit dhe shitësit online nuk përcakton detyrime, atëherë kjo kthehet në një kontratë autorizimi (vekale). Në këtë rast blerësi autorizon shitësin online për t'i siguruar produktin dhe i autorizuari merr fitimin për shërbimin që ofron. Për të realizuar këtë shitësi online duhet të bëjë të qarta termat e shërbimit të tij në faqen online, në mënyrë që blerësit të jenë të informuar plotësisht për shërbimin që u ofrohet.

## **3 – Selem dhe istisna'**

Kontrata selem dhe istisna' janë praktika që prej kohës së Profetit (a.s) dhe ndër më të njohurat në jurisprudencën islame. Kontratat e shitjes kanë detyrim që produktet që shkëmbehen të njihen mirë dhe të mos ketë dyshime të asnjë lloji në kontrata, në mënyrë që të shmangët çdo lloj konflikti. Por shpeshherë ndodh që njerëzit të kenë nevojë për produkte që përkohësisht mund të mos jenë në dispozicion ose që s'gjenden në treg. Jurisprudenca islame këto raste i ka zgjidhur me kontratat selem dhe istisna'. Selem do të thotë që personi të shesë një produkt standard të identifikuar nëpërmjet sasisë, llojit dhe veçorive (mithli), të cilin nuk e ka ende në zotërim, por që gjendet me lehtësi në treg, duke marrë paraprakisht pagesë të plotë me idenë, që produktin do t'ia dorëzojë më pas në kohën e përcaktuar. Profeti (a.s) ka thënë: "Kush bën selem për diçka, ta bëjë atë me sasi, peshë dhe kohë të përcaktuar." (Buhari, Selem, 1, 2, 7; Muslim, Musakat, 128) Istisna' do të thotë të porosisësh një produkt që nuk gjendet në treg, që është unik, si një pikturë, statujë, veshje e posaçme, punimet e dorës, etj. Edhe në këtë rast bëhet pagesa e plotë paraprakisht dhe produkti dorëzohet në kohën e përcaktuar.

– Së pari, dropshipping përngjason shumë me selemin, por ka edhe diferenca domethënëse nga aspekti i jurisprudencës islame, që e ndajnë. Nëse shitja online kthehet në një kontratë selemi dhe zbatohen dispozitat e saj, atëherë kjo kthehet në një praktikë të lejuar nga ana islame. Për të bërë këtë në radhë të parë duhet që produkti të jetë i disponueshëm në treg, sepse diçka që ka mundësi të mos gjendet konsiderohet madum (inekzistent) dhe shitja e diçkaje që nuk ekziston është e ndaluar. Produkti, ekzistenca e të cilit është e dyshimtë, mund të shitet vetëm pasi shitësi e ka marrë në dorëzim. Por kur flasim për produktet që prodhohen me shumicë, ato mund të gjenden lirshëm në pika të ndryshme furnizimi, sepse në përgjithësi janë gjëra që njerëzve i nevojiten dhe prodhohen me aq fluks sa që shoqëria thuhet asnjëherë nuk vuan për t'i siguruar. Produkti i dropshipping duhet të jetë në këtë kategori, që të quhet selem.

– Së dyti, blerësi duhet të këtë informacionet e nevojshme rreth produktit. Kushtet e selemit janë që

të identifikohen qartësisht veçoritë (Profeti (a.s) ka kushtëzuar të përcaktohen lloji, masa, sasia, pesha, etj.), të jetë e gjindshme në treg dhe të përcaktohet koha e dorëzimit.

Për realizimin e kësaj kontrate si selem, nevojitet që të sigurohen dy elemente thelbësore: (1) dorëzimi tek blerësi dhe (2) dëmshpërblimi në rast të kundërt. Kjo është edhe një nga diferencat mes selemit dhe shitjes klasike, sepse tek kjo e fundit nevojitet pronësia e produktit që shet.

– Së treti, s'duhet anashkaluar fakti se blerësi në përgjithësi është në dijeni që furnizuesi nuk është dyqani ku po blen online, por një palë e tretë. Kështu që di edhe se shitësi online është vetëm një ndërmjetës. Ai pranon të bëjë një blerje në këto rrethana. Kështu, në aspektin juridiko-fetar, mund të thuhet që në një farë mënyre tashmë kjo praktikë është kthyer në zakon (urf). Tradita dhe zakoni është element i njohur nga jurisprudenca dhe ka vlerë juridike. Nisur nga kjo, arrihet në konkluzionin e përgjithshëm që nëse nuk ka rrezik në lidhje me dorëzimin e produktit, atëherë këto lloj kontratash janë të lejuara.

– Së katërti, dorëzimin e produktit duhet ta bëjë ndërmjetësi dhe jo shitësi. Kjo është edhe metoda e selemit në kohën e Profetit (a.s). Për të zgjidhur këtë problematikë ndërmjetësi mund të bëjë një marrëveshje me furnizuesin ose vetë dorëzuesin, duke e autorizuar për dorëzimin. Si dhe të bëjë të ditur publikisht që ai nuk i posedon produktet që shet, por që i gjen dhe i vë në dispozicion të blerësit. Paga duhet të dorëzohet e plotë, jo pjesërisht.

## **KONKLUZION**

Ligji islam nuk ndalon a-priori praktikën e dropshipping. Por duke qenë se kjo praktikë ka forma të ndryshme, quhet elejuar pasi janë plotësuar në formë të qartë kushtet që kërkon feja islame. Shmangia e abuzimeve është çështja më jetike në marrëdhëniet financiare. Kompani të mëdha si Amazon i kanë rregulluar këto shitje me ligj dhe marrëveshje me filialet online, duke reduktuar thuajse në zero mundësitë e abuzimit. Është e vështirë që çështjet financiare t'ia lësh në dorë koshiencës së gjithkujt. Kryesisht në hapësirat gjeografike, ku shitjet online janë të parregulluara me ligj, rreziku për abuzim është shumë i madh. Në ditët e sotme rolin kryesor për të shmangur çdo abuzim duhet ta luajnë autoritetet kompetente, sepse format e tregtisë janë të pandalshme. Ne më sipër shprehëm në parim disa zgjidhje praktike, të cilat duhet të marrin formën e tyre finale duke u konkretizuar rast pas rasti. Për këtë arsye, një besimtar mysliman që kërkon të dijë nëse forma se si aplikon dropshipping është brenda kriterëve islame apo jo, duhet t'i drejtohet autoriteteve kompetente fetare për të marrë një vlerësim të qartë dhe final.

**Këshilli i çështjeve fetare - insi.al**

# NE JEMI FAJI DHE ZGJIDHJA



Një model përkujdesjeje për të rinjtë: Mentorimi i personalizuar dhe roli i tij në edukimin e brezave

Ngjarjet tronditëse si ajo e vrasjes së një adoleshenti 14-vjeçar, ku një tjetër bashkëmohatar u plagos, kanë shokuar sërish shoqërinë shqiptare dhe kanë ngritur pikëpyetje të mëdha mbi gjendjen morale dhe sociale të brezit të ri. Shoqëria jonë, e përballur me sfida të shumta në jetën e përditshme, ndonjëherë duket e mpirë ndaj shenjave alarmuese që tregojnë përhapjen e dhunës, mungesën e empatisë dhe rënien e përgjegjësisë sociale. Një akt kaq barbar si kjo ngjarje e fundit duket se shërben si një kamberë zgjimi për të tërhequr vëmendjen e opinionit publik dhe për të diskutuar më thellësisht se si mund të adresohen këto probleme në mënyrë efektive.

Zgjidhja e problemeve që prekin adoleshentët, si dhuna dhe devijimi social, ka shumë dimensione që duhen adresuar. Prindërimi i përgjegjshëm, një sistem arsimor i fortë, media që promovon vlera pozitive, kultura shoqërore që reflekton moral dhe solidaritet, ligje që mbrojnë dhe drejtojnë, institucione fetare aktive, si dhe ndikimi i artit dhe muzikës, janë të gjitha faktorë kyç në formimin e shëndetshëm të brezave të rinj. Megjithatë, në këtë shkrim do të fokusohem vetëm te një dimension i rëndësishëm që kontribuon në edukimin dhe zhvillimin moral të fëmijëve: sistemi i mentorimit.

Mentorimi i strukturuar dhe me qasje të personalizuar mund të shërbejë si një urë lidhëse mes të rinjve dhe një edukimi të qëndrueshëm. Përmes modelit të mentorimit, jo vetëm që ndihmojmë në ndërtimin e karakterit, por krijojmë gjithashtu një sistem mbështetës që mund t'i udhëzojë të rinjtë drejt një jete të ndritur dhe larg ndikimeve negative.

Në realitet, shpresa për të ndrequr një situatë të tillë nuk mund të vendoset e gjitha mbi sistemin politik të korruptuar që karakterizon shumë vende në zhvillim, përfshirë edhe Shqipërinë. Për këtë arsye, shumë organizata dhe lëvizje të shoqërisë civile kanë marrë përsipër nismën për të ndërtuar një të ardhme më të shëndetshme për të rinjtë përmes arsimit, ndërgjegjësimit dhe mentorimit. Një ndër këto përpjekje është ajo e Lëvizjes Gylen, e cila gjate dekadave ka ndërtuar një sistem të veçantë mentorimi për edukimin

Roli i mentorimit të personalizuar në edukimin e brezave të rinj

Mentorimi i Personalizuar i përdorur nga kjo lëvizje bazohet në krijimin e një marrëdhënieje

Një model përkujdesjeje për të rinjtë: Mentorimi i personalizuar dhe roli i tij në edukimin e brezave

Ngjarjet tronditëse si ajo e vrasjes së një adoleshenti 14-vjeçar, ku një tjetër bashkëmohatar u plagos, kanë shokuar sërish shoqërinë shqiptare dhe kanë ngritur pikëpyetje të mëdha mbi gjendjen morale dhe sociale të brezit të ri. Shoqëria jonë, e përballur me sfida të shumta në jetën e përditshme, ndonjëherë duket e mpirë ndaj shenjave alarmuese që tregojnë përhapjen e dhunës, mungesën e empatisë dhe rënien e përgjegjësisë sociale. Një akt kaq barbar si kjo ngjarje e fundit duket se shërben si një kamberë zgjimi për të tërhequr vëmendjen e opinionit publik dhe për të diskutuar më thellësisht se si mund të adresohen këto probleme në mënyrë efektive.

Zgjidhja e problemeve që prekin adoleshentët, si dhuna dhe devijimi social, ka shumë dimensione që duhen adresuar. Prindërimi i përgjegjshëm, një sistem arsimor i fortë, media që promovon vlera pozitive, kultura shoqërore që reflekton moral dhe solidaritet, ligje që mbrojnë dhe drejtojnë, institucione fetare aktive, si dhe ndikimi i artit dhe muzikës, janë të gjitha faktorë kyç në formimin e shëndetshëm të brezave të rinj. Megjithatë, në këtë shkrim do të fokusohem vetëm te një dimension i rëndësishëm që kontribuon në edukimin dhe zhvillimin moral të fëmijëve: sistemi i mentorimit.

Mentorimi i strukturuar dhe me qasje të personalizuar mund të shërbejë si një urë lidhëse mes të rinjve dhe një edukimi të qëndrueshëm. Përmes modelit të mentorimit, jo vetëm që ndihmojmë në ndërtimin e karakterit, por krijojmë gjithashtu një sistem mbështetës që mund t'i udhëzojë të rinjtë drejt një jete të ndritur dhe larg ndikimeve negative.

Në realitet, shpresa për të ndrequr një situatë të tillë nuk mund të vendoset e gjitha mbi sistemin politik të korruptuar që karakterizon shumë vende në zhvillim, përfshirë edhe Shqipërinë. Për këtë arsye, shumë organizata dhe lëvizje të shoqërisë civile kanë marrë përsipër nismën për të ndërtuar një të ardhme më të shëndetshme për të rinjtë përmes arsimit, ndërgjegjësimit dhe mentorimit. Një ndër këto përpjekje është ajo e Lëvizjes Gylen, e cila gjate dekadave ka ndërtuar një sistem të veçantë mentorimi për edukimin e brezave të rinj, duke u përqendruar te zhvillimi i tyre moral, shpirtëror dhe intelektual.

Roli i mentorimit të personalizuar në edukimin e brezave të rinj

Mentorimi i Personalizuar i përdorur nga kjo

lëvizje bazohet në krijimin e një marrëdhënieje të ngushtë midis mentorit dhe adoleshentëve. Kjo qasje është unike, pasi përqëndrohet te nevojat individuale të çdo personi dhe ndërton një bazë të fortë morale përmes shembullit të mirë, kujdesit të vazhdueshëm dhe udhëzimeve të personalizuar.

Ky mentorim nuk synon vetëm të zhvillojë një lidhje emocionale me të rinjtë, por edhe të krijojë një mjedis mbështetës ku ata mund të ndihen të vlerësuar, të dëgjuar dhe të frymëzuar për të ndjekur një rrugë të drejtë në jetë. Në thelb qëndron ideja që për të parandaluar rënien e të rinjve në gracka si dhuna, droga apo alkooli, është e domosdoshme t'u ofrohet një shembull i fortë moral dhe një sistem vlerash që i drejton drejt një jete me qëllim dhe përgjegjësi.

Shtyllat Kryesore të Mentorimit të Personalizuar

Mentorimi i Personalizuar mbështetet mbi tri shtylla kryesore që bashkëveprojnë për të krijuar një proces të suksesshëm edukimi:

#### 1. Lidhja Individuale me Mentorin

• Të rinjtë lidhen me mentorin, të cilin cilët veprojnë si udhërrëfytes dhe mbështetës në çdo hap të zhvillimit të tyre. Ky raport përfshin takime të rregullta ku diskutohet për sfidat, qëllimet dhe aspiratat personale. Kjo ndihmon në identifikimin dhe adresimin e problemeve specifike që mund të rrezikojnë zhvillimin e shëndetshëm të të rinjve.

#### 2. Frymëzimi përmes Shembullit të Mirë

• Mentorët janë modele të jetës morale dhe të suksesit profesional. Duke treguar me veprimet e tyre se si mund të arrihet një jetë me vlera dhe qëllim, ata frymëzojnë të rinjtë të ndjekin të njëjtën rrugë. Ky aspekt është thelbësor për të larguar të rinjtë nga ndikimet negative si droga, alkooli dhe sjelljet destruktive.

#### 3. Angazhimi në Aktivitete Shoqërore dhe Edukative

• Mentorimi i Personalizuar përfshin gjithashtu organizimin e aktiviteteve komunitare, leximeve të teksteve të shenjta dhe programeve edukative. Këto aktivitete ndihmojnë të rinjtë të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë sociale dhe t'u japin mundësi të mësojnë aftësi të reja duke qenë pjesë e një mjedisi të sigurt dhe pozitiv.

Parandalimi i dhunës dhe sjelljeve negative përmes mentorimit

Në një shoqëri ku të rinjtë shpesh përballen me presionin e bashkëmoshatarëve, mungesën e mbështetjes familjare dhe ndikimin negativ të mediave sociale, sistemi i mentorimit vepron si një mburojë mbrojtëse. Përmes një lidhjeje

të fortë me mentorin dhe aktiviteteve që përqëndrohen te zhvillimi moral dhe intelektual, të rinjtë mund të mësojnë të njohin dhe të shmangin ndikimet negative.

Për shembull, një adoleshent që merr mbështetje nga një mentor ka më shumë gjasa të zhvillojë vetëbesim dhe të kuptojë se si të menaxhojë emocionet dhe konfliktet. Në vend që të përfshihet në akte dhune ose të bjerë pre e drogës dhe alkoolit, ai do të përpikët të ndjekë një rrugë më të shëndetshme dhe konstruktive.

Ngjarjet tragjike si vrasja e adoleshentëve janë një thirrje për zgjim të menjëhershëm të shoqërisë shqiptare. Zgjidhja e këtyre problemeve kërkon përpjekje të përbashkëta që tejkalojnë kufijtë e sistemit politik dhe shtrihen në përgjegjësinë e shoqërisë civile.

Në vend që të presim një ndryshim të papritur vec nga institucionet politike, është koha që shoqëria të ndërmarrë hapa konkrete për të edukuar dhe udhëhequr brezat e rinj drejt një rruge të drejtë dhe të ndritshme.

Edhe prindërvet u takon një rol i madh dhe i pazëvendësueshëm në edukimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga ndikimet negative të shoqërisë. Ata kanë përgjegjësitë e para dhe më të rëndësishme në jetën e fëmijës, duke ndërtuar themelet e moralit, sjelljes dhe botëkuptimit të tyre. Një prind që shpenzon kohë cilësore me fëmijën, dëgjon shqetësimet e tij dhe i ofron mbështetje të vazhdueshme, ndihmon në krijimin e një mjedisi të ngrohtë dhe të sigurt, ku fëmija ndihet i vlerësuar dhe i mbrojtur.

Gjithashtu, është detyrë e prindërvet të jenë shembull i mirë në sjelljet dhe vlerat që përçojnë. Fëmijët mësojnë më shumë nga ajo që shohin sesa nga ajo që dëgjojnë, prandaj një prind që modelon ndershmërinë, përgjegjësinë dhe disiplinën do të ketë një ndikim të madh në zhvillimin e fëmijës. Duke treguar kujdes për edukimin shpirtëror dhe intelektual të tyre, duke kufizuar ndikimet e dëmshme nga teknologjia dhe shoqëria, prindërit mund të ndihmojnë në formimin e një brezi që është i vetëdijshëm për vlerat dhe qëndron larg sjelljeve destruktive si dhuna, droga dhe alkooli.

Mentorimi i Personalizuar është vec një prekshumç hapave të rëndësishëm që duhen hedhur në kërkim të drejtë, duke ofruar një qasje të mbështetur në vlera të forta për t'i ndihmuar të rinjtë të kapërcejnë sfidat e jetës dhe të ndërtojnë një shoqëri më të shëndetshme.

Zoti na i ruajt fëmijët! Zoti na bëftë çelës të së mirës dhe dry të së keqes!

**Gazmend Aga**



# A e njohin kafshët fizikën e fluturimit?

Me zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë, po kuptohet se shumë dukuri që më parë i konsideronim të thjeshta përmbajnë në thelb dizajn, arkitekturë dhe plane inxhinierike. Shkencëtarët që punojnë në fushën e robotikës, mekanikës dhe statikës, edhe vetëm në procesin e ecjes, përballen me dhjetëra ekuacione matematikore, formula fizike dhe llogaritje inxhinierike. Nëse shikojmë gjendjen e fundit të robotëve mbi të cilët janë punuar për vite me radhë, mund të vërejmë se ata nuk mund të ecin në mënyrë të përsosur si një njeri i krijuar nga Allahu. Ashtu si në ecje, edhe në funksionet e notimit në ujë dhe fluturimit në ajër, mund të shohim që janë vlerësuar dhe krijuar me një natyrë shumë precize anatomia dhe fiziologjia, bashkë me ligjet që përcaktohen nga shkencat e fizikës dhe matematikës.

Kur përmendet fluturimi, gjëja e parë që na vjen në mendje janë zogjtë. Në shprehje si 'të fluturosh si një zog' apo të ngjashme, fluturimi është identifikuar me zogjtë. Njerëzit, duke parë zogjtë, gjithmonë kanë ëndërruar që të fluturojnë lirshëm dhe lehtësisht si ata, dhe të përshkojnë distanca të gjata përmes rrugëve të shkurtra. Si fillim të përpjekjeve për fluturim përmenden andaliziai Ibn Firnasi në shekullin e 9-të dhe Hezarfen Ahmet Çelebi, që jetoi në Stamboll në shekullin e 16-të. Në Kur'anin e Shenjtë, fluturimi tërheq vëmendjen dhe disa veçori theksohen: 'A nuk i shohin zogjtë që qëndrojnë në radhë dhe fluturojnë duke hapur dhe mbyllur krahët e tyre? Nuk ka tjetër përveçse Fuqplotit që i mban ata në ajër. Ai me siguri sheh gjithçka.' (Mulk, 67/19). Në ajet theksohen tri çështje: e para, 'fluturimi i zogjve në radhë-radhë', e dyta, 'hapja dhe





mbyllja e krahëve gjatë fluturimit', dhe e treta, 'të qenit Zoti si arsyja pse qëndrojnë në ajër'. Po mirë, cilat janë shkaqet që Allahu (qoftë lartësuar madhështia e Tij) përdor si perde për të mbajtur zogjtë në ajër? Kur e shqyrtojmë tërësisht anatominë dhe fiziologjinë e përshtatshme të zogjve për fluturim, modelin e sjelljes që ata përdorin për fluturim dhe ligjet e fizikës që qëndrojnë prapa kësaj, mund të kuptojmë se prej nga kanë marrë frymëzimin inxhinierët e aeroplanëve.

#### **A fluturojnë vetëm zogjtë?**

Kur mendojmë për kafshët që fluturojnë përveç zogjve, e dimë se disa peshq, bretkosa, hardhuca dhe kafshë si lakuriqi i natës, si kurrizorë që janë, mund të fluturojnë, dhe ndër jokurrizorët, insektet me krahë gjithashtu fluturojnë. Asnjë prej grupeve të tjera të vertebrorëve, nga peshqit

te ketri (përveç lakuriqëve të natës), nuk fluturon duke rrahur krahët si zogjtë; këto kafshë mund të përshkojnë një distancë të shkurtër duke u lëshuar si një rrëshqitës nga një vend i lartë, duke shtrirë lëkurën në anët e krahëve, këmbëve dhe trupave të tyre. Fluturimi i këtyre kafshëve ndryshon nga ai i zogjve. Prandaj, Kur'ani i Shenjtë, si burim informacioni për fluturimin, përmend drejtpërdrejt vetëm zogjtë.

Kur i shikojmë kafshët fluturuese të përmendura më lart, shohim se Allahu (xhel-le xhelaluhu) ka shfaqur fuqinë e Tij në kategori të ndryshme taksonomike dhe për të treguar se mund të veprojë në pronën e Tij si të dojë, ka treguar se mund të bëjë të fluturojë çdo krijesë, pa qenë i kufizuar nga ndonjë formë e caktuar. Pra, sa të ngjashme janë karakteristikat e fluturimit dhe ligjet e fizikës që zbatohen te këto

grupe kafshësh me struktura trupore kaq të ndryshme?

### **Peshku fluturues**

Fluturimi i këtij lloji peshku, me pendët e kraharorit shumë të mëdha, pothuajse sa gjatësia e trupit të tij, nuk është si ai i zogjve. Kur peshku arrin një shpejtësi të caktuar gjatë notimit, ai kërcenë jashtë ujit dhe hap pendët anash, duke marrë formën tipike të një rrëshqitësi. Ajri që futet nën këto pendë e ndihmon peshkun të rrëshqasë për një kohë të shkurtër jashtë ujit. Gjatë kësaj kohe, kur hapësirat nën pendë mbushen me ajër nga një shpejtësi e caktuar e ulët, krijohet një forcë ngritëse që i mundëson peshkut të ngrihet lart. Sa më shumë që ajri të përplaset dhe të ngjeshet nën pendët, aq më gjatë vazhdon peshku të rrëshqasë. Pendët përdoren për të mbajtur forcën ngritëse të peshkut derisa ai të hyjë përsëri në ujë. Me nxitim, peshku arrin të ngrihet lart dhe të fitojë lartësi përpara se të ndikojë graviteti.

### **Bretkosa fluturuese**

Në Afrikën Sub-Saharane dhe Azinë Juglindore ekzistojnë rreth 380 lloje të bretkosave fluturuese, të cilat zakonisht jetojnë në pemë. Më e njohura ndër to, *Rhacophorus nigropalmatus*,<sup>1</sup> banon në pyjet tropikale të shiut.

Edhe pse quhen “bretkosa fluturuese”, ato në fakt nuk fluturojnë, por rrëshqasin në ajër. Ato zbresin nga një lartësi e madhe duke rrëshqitur me një kënd të caktuar zbritjeje. Për një avion, një lloj i tillë rrëshqitjeje do të ishte i pamundur dhe do të rrezohet menjëherë, por bretkosat kanë trupa të lehtë që zvogëlojnë forcat që ndikojnë mbi to. Lloji *Rhacophorus nigropalmatus* mund të rrëshqasë deri në 15 metra. Për më tepër, ato mund të zbresin mbi një liqen ose një gjethe të butë, duke zvogëluar forcat e përplasjes.

A mund të zhvillojë bretkosa vetë aftësinë për të rrëshqitur në ajër? Si e di se duhet të ketë një sipërfaqe të madhe të shtrirë ndërmjet gishtave të gjatë të këmbëve për të fluturuar? Si e kupton dhe përdor ajo formulën fizike që lidh strukturën e trupit të saj, sipërfaqen e këmbëve dhe forcën ngritëse të ajrit?

1. Lloji i bretkosave “*Rhacophorus nigropalmatus*” përkthehet nga latinishtja si “bretkosa me pëllëmbë të zezë” ose “bretkosa me duar të zeza.” (Përkthyesi).

### **Zhapini dhe Gjarpri fluturues**

Zhapini Parashutë (*Gekko mizoramensis*) dhe Dragoi Fluturues (*Draco volans*) përdorin krahët prej lëkure të lidhur në anët e trupit dhe bishtit të tyre për të rrëshqitur në ajër. Zhapinjtë fluturues, që jetojnë në një lartësi prej 1,5-3,5 metrash nga toka, shtrijnë lëkurën e hollë që u varet nga anët e trupit dhe rrëshqasin nga lartësitë drejt poshtë. Ata shtrijnë këtë lëkurë të hollë, që mbështetet nga gjashtë brinjë, duke krijuar një sipërfaqe të gjerë si krahët dhe rrëshqasin si një rrëshqitës, duke fluturuar me një kënd të pjerrët në ajër.

Lloji i gjarprit *Chrysopelea paradisi*, i njohur si “Gjarpri Fluturues”, është në gjendje të ngjitet deri në 15-20 metra në pemë dhe më pas të hidhet duke fluturuar. Teknikat e fluturimit të këtyre gjarpërinjve bazohen në aftësinë e tyre për të zgjatur kohën që qëndrojnë në ajër dhe për të ngadalësuar shpejtësinë e rënies. Kur hidhen nga një lartësi, ata zgjerojnë trupin e tyre anash, duke krijuar një sipërfaqe më të gjerë, dhe kështu rrëshqasin në ajër. Për të kontrolluar drejtimin, ata përdorin kthesat e trupit dhe bishtin e tyre. Ata përfitojnë nga karakteristikat e tyre aerodinamike të krijuara nga natyra për të rrëshqitur, duke perceptuar forcat që ndikojnë në trupin e tyre dhe duke i përkulur ato për të krijuar një sipërfaqe më të gjerë fluturimi.

### **Gjitarët fluturues**

Edhe pse lakuriqët e natës janë gjitarë, ata fluturojnë në mënyrë të ngjashme me zogjtë, por pajisjet e tyre janë të ndryshme nga ato të zogjve. Anatomia e tyre është pjesërisht e ngjashme, por fiziologjia ndryshon. Lakuriqët e natës përbëjnë një çerek të të gjitha llojeve të gjitarëve dhe kanë një larmi të madhe llojesh. Në mesin e gjitarëve, ekzistojnë gjithashtu disa lloje që fluturojnë në mënyrë rrëshqitëse.

Ketrat fluturues janë një tjetër grup gjitarësh që kanë lëkurë elastike të cilën e zgjerojnë dhe përdorin për të fluturuar. Ekzistojnë rreth 35 lloje të ndryshme të ketrash fluturues, të cilët përdorin bishtin e tyre si timon për të drejtuar fluturimin. Ata mund të ngjiten deri në 30-40 metra lartësi nëpër pemë dhe të rrëshqasin poshtë.

Ndër gjitarët marsupialë, ka gjithashtu shumë gjitarë që fluturojnë. Femrat e këtyre kafshëve mbajnë të

vegjlit e tyre në xhepat e barkut ndërsa fluturojnë. Një grup tjetër janë lemuret fluturues, të njohur si Clugo. Ky gjitar, me madhësinë e një maceje, është gjitari më i madh që fluturon duke rrëshqitur. Ata hapin lëkurën e tyre për të ngritur në ajër dhe gjatë fluturimit marrin formën e një fluturë.

### **Insektet fluturuese**

Insektet, të cilat janë krejtësisht të ndryshme nga zogjtë, kanë anatomi dhe fiziologji shumë të ndryshme. Ato fluturojnë me dy ose katër krahë duke përdorur teknika të ndryshme. Lëvizjet e tyre, si te mizat, bletët, fluturat dhe xixëllonjat, janë studiuar përmes ekuacioneve komplekse matematike.

### **A kanë mësuar këto krijesa fizikë e matematikë?**

Rreth 10,000 lloje zogjsh, qindra lloje peshqish, breshka dhe zvarranikë, si dhe qindra mijëra lloje insektesh fluturojnë. Çdo lloj zogu ka një formë të ndryshme të trupit, krahëve dhe bishtit. Fluturimi i këtyre zogjve të ndryshëm, si për shembull pëllumbi, zogu i mjegullës, shqiponja, pelikani, merimanga, gjarpri, dhe patku, është krijuar sipas formave të trupit, krahëve dhe bishtit të tyre, duke iu përshtatur dimensioneve dhe ligjeve të ndryshme.

Inxhinierët e aviacionit gjithashtu përdorin llogaritë e ndryshme në projektimin e avionëve të pasagjerëve, si dhe të avionëve ushtarakë ose kargo. Në avionët që fluturojnë pa energji motorike, si planorët, forma e krahëve është projektuar të jetë më e hollë dhe më e gjatë, duke përdorur parimet dhe ligjet e sakta të matematikës dhe fizikës. Një grup insektesh, të cilat përbëjnë një botë të çuditshme, kanë forma të ndryshme të krahëve, këmbëve dhe trupit, duke iu përshtatur mekanizmave të ndryshëm të fluturimit, që shkojnë nga mizat deri te bletët, nga insektet helikopter deri te zgjidhësit. Teknikat e fluturimit të insekteve me katër krahë ndryshojnë ndjeshëm nga ato me dy krahë.

Të gjitha këto fluturime përfshijnë ligjin fizik që përshkruan një nga parimet themelore të dinamikës së lëngjeve, i njohur si parimi i Bernoulli-t. Ky parim tregon se kur shpejtësia e një lëngu, si ajri, rritet, presioni i tij ulët, dhe e kundërta gjithashtu është e vërtetë. Në kontekstin e aerodinamikës, kur një aeroplan lëviz në ajër, forma e krahëve të tij është projektuar në mënyrë

që ajri që rrjedh mbi sipërfaqen e kavalizuar të sipërme të krahut të lëvizë më shpejt se ajri që rrjedh poshtë tij. Kjo krijon një diferencë presioni, me presion më të ulët mbi krah dhe presion më të lartë poshtë tij. Diferenca e presionit prodhon forcën e ngritjes, e cila i mundëson aeroplanit të kapërcejë gravitetin dhe të qëndrojë në ajër.

Gjatë aktivitetit të fluturimit, ligjet e tjera fizike, si ligjet e lëvizjes që zbuloi Njutoni, janë gjithashtu në fuqi. Për shembull, ligji i tretë i Njutonit, i shprehur si "Për çdo veprim, ka një forcë të barabartë dhe të kundërt", shpjegon se si motorët e aeroplanit krijojnë forcën e shtytjes duke fryrë ajrin mbrapa dhe duke e lëvizur aeroplanin përpara. Katër forcat që veprojnë mbi një aeroplan janë: shtytja (përpara), rezistenca (mbrapa), ngritja (lart) dhe pesha (poshtë), dhe kombinimi i këtyre parimeve dhe ligjeve fizike të formuluar nga Njutoni e mundëson fluturimin e aeroplanit.

Një objekt duhet të ketë katër forca në balancë të saktë për të fluturuar. Për të arritur të kapërcejë forcën e rezistencës dhe të fitojë gravitetin, nevojiten forcë shtytëse dhe forcë ngritëse. Helikopterët dhe raketat gjithashtu përdorin të njëjtat forca për fluturim. Madje edhe fluturuesit përdorin këto forca fizike për të ngritur lart.

Një kafshë që nuk di për forcën e ngritjes së ajrit dhe parimet fizike, natyrisht, nuk do të dijë se ka nevojë për krahë dhe pajisje fiziologjike shtesë për të fluturuar. Ligjet fizike që janë në fuqi në botën tonë kanë qenë të pranishme që nga krijimi i saj, por ideja e fluturimit na ka ardhur në mendje vetëm në shekujt e fundit. Për zogjtë dhe kafshët e tjera, arritja e forcës ngritëse përmes zgjerimit të sipërfaqes së trupit, thyerjes së ajrit, fluturimit dhe tundjes së krahëve ka kërkuar disa shekuj që të aplikohet teknologjikisht. Nëse i shohim krijesat fluturuese nga ky këndvështrim, ndoshta do të zbulojmë se ato janë të pajisura me shumë mençuri që ende nuk i dimë.

**Prof. Dr. İrfan Yılmaz**

# Të gjesh qetësi me Ibadet

Në klasën ku isha mësuese kujdestare kishte ardhur një nxënës i ri. Me kalimin e kohës, vura re se ai ishte i pakënaqur dhe i shqetësuar. Nuk po mundej të përqendrohej në mësimet dhe ishte gjithnjë i menduar. Kur e pyeta për arsyen e kësaj gjendjeje, më tha se për shkak të vështirësive me të cilat duhej të përballlej, ishte vazhdimisht në stres dhe ankth, se nuk po i duronte më ndryshimet në jetën e tij dhe nuk e dinte ku ta kërkonte zgjidhjen. M'u kujtua në atë çast një hadith i të Dërguarit tonë (sallallahu alejhi ve selam): "Çdo sëmundje ka një shërim. Edhe sëmundja që ka një shërim kalon vetëm me lejen e Allahut."<sup>1</sup>

Pa njohjen dhe dashurinë ndaj Allahut nuk është e mundur të arrihet lumturia e vërtetë. Vetëm duke qenë rob i Allahut (xhelle xhelaluhu) mund të gjejmë qetësi. Këtë mendim e ndava me nxënësin tim. Ai, me ndjenjën se mund të gjente një zgjidhje, më shikoi me kureshtje duke pritur shpjegimet e mia.

Çrregullimi i ankthit është një gjendje psikologjike që shfaqet me ndjenja të papritura dhe të forta frike, shqetësimi dhe parehatie përballë një kërcënimi ose burimi stresi që po afrohet. Në disa raste, ankthi mund ta lehtësojë përqendrimin dhe të ndihmojë në përballimin e situatave stresuese. Megjithatë, menaxhimi i gabuar i ankthit dhe stresit mund të çojë në disa probleme. Ne përipiqemi t'i zgjidhim këto probleme përmes terapisë ose ndihmës së ilaçeve. Gjatë periudhave të lodhshme, stresuese dhe rraskapitëse, përdorim metoda të ndryshme për të qetësuar mendjen dhe trupin, duke kërkuar qetësinë.

I Dërguari ynë (sallallahu alejhi ve sellem) gjithmonë e kërkonte qetësinë dhe lumturinë në adhurim, në afrimin ndaj Allahut. Në kohën e Tij nuk kishte as psikologë, as antidepressantë. Qetësinë që gjejmë pranë njerëzve të përkryer nuk mund ta gjejmë askund tjetër. Fjalët dhe veprat e robërve të devotshëm të Allahut janë plot me këshilla që na ndihmojnë të dalim nga vështirësitë që përjetojmë. Sigurisht, nuk duhet ta harrojmë këtë: Në çrregullime depresive, çrregullime të ankthit dhe të ngjashme, niveli i serotoninës bie. Po ashtu ndodhin ndryshime edhe në vlerat e disa neurotransmetuesve (substancë kimike që transportojnë sinjale mes qelizave nervore). Në raste të tilla mund të na nevojitet të marrim ilaçe me ndihmën e një mjeku.

1. Muslim, Selam, 69.

## Kërkimi i Zgjidhjes

Ekzistojnë lloje të ndryshme të ankthit. Çrregullimi i ankthit të lidhur me situata specifike, ankthi i përgjithësuar dhe ataku i panikut janë ndër më të zakonshmet. Ndjenja e stresit te personi ndikon negativisht në jetën e tij të përditshme. Personat që përjetojnë çrregullim ankthi zakonisht mendojnë për skenarin më të keq. Ngjarjet e së kaluarës dhe pasiguria e së ardhmes i shqetësojnë ata. Barra e së kaluarës dhe frika e së ardhmes e bëjnë pothuajse të pamundur jetesën e qetë në të tashmen dhe e lodhin njeriun. Përballimi me këtë situatë është i vështirë, sepse ndërhyrja për të menaxhuar stresin për këta persona shndërrohet në një faktor tjetër stresi.

Metodat e rekomanduara të terapisë zakonisht përfshijnë një proces të gjatë. Për njerëzit që punojnë me një ritëm të ngjeshur, pjesëmarrja e rregullt në seanca mund të jetë sfiduese. Për më tepër, kostoja e marrjes së shërbimeve nga një specialist është e lartë dhe trajtimi nuk jep gjithmonë rezultate të sigurta. Antidepressantët e rekomanduar në proceset e trajtimit psikologjik duhet të përdoren nën mbikëqyrjen e një psikiatri ose mjeku. Ndonjëherë, terapistët mund t'i interpretojnë gabimisht përvojat e tyre për pacientin ose të japin këshilla që nuk janë të përshtatshme për natyrën njerëzore. Prandaj, është e rëndësishme të konsultoheni me një psikolog ose psikiatër të devotshëm.

## Dhikri, Adhurimi dhe Meditimi

Ekzistojnë tri mjete të rëndësishme që ndihmojnë njeriun të gjejë paqen e brendshme:

### 1. Dhikri

"Dhikri, ashtu si falënderimi, është një detyrë dhe një borxh ndaj Zotit, që kryhet me gjuhë, zemër, trup dhe me të gjitha pjesët e ndërgjegjes. Të përmendësh të Madhërismin me të gjitha emrat e Tij të bukur dhe me të gjitha cilësitë e Tij të shenjta, të buçasësh me lavdërimin dhe madhërimin e Tij, të përforcosh me tesbih dhe madhërim kur është e nevojshme, të përjetosh entuziazëm me tekbr dhe respekt, dhe të kërkosh strehim në udhëzimin e Tij duke lexuar Kur'an; të recitosh kuptimet e fshehta të Librit të Krijimit në librin e universit; të shpallësh me gjuhën tënde dobësinë dhe varfërinë tënde përpara Tij... Po, të gjitha këto janë pjesë e dhikrit që kryhet me gjuhë."

Emrat e Allahut (Esmau'l-Husna) janë thesare të shenjta që



mund të shërbejnë për të gjetur paqe dhe qetësi. Për shembull, një person që dëshiron të ndiejë kënaqësi shpirtërore duke kujtuar mirësitë e Allahut, mund ta përmendë emrin "El-Latif."

Ajetet si: "Përmende emrin e lartësuar të Zotit tënd, shpëto nga varësia ndaj gjërave kalimtare dhe drejtohu tërësisht tek Ai." (Muzzemmil, 73/8) dhe "Dijeni se vetëm me përmendjen e Allahut gjejnë paqe zemrat." (Ra'd, 13/28) theksojnë forcën dhe rëndësinë e dhikrit. Këtu, e rëndësishme është që njeriu të largohet nga gjërat që i shpërqendrojnë mendjen dhe të afrohet tek Allahu përmes dhikrit. Sa i nevojshëm është njeriu për t'u larguar nga gjithçka dhe për të mbetur vetëm për vetëm me Allahun!

## 2. Ibadeti

Sot, përballimi me stresin dhe trajtimi i çrregullimit të ankthit rekomandohen përmes ushtrimeve të frymëmarrjes dhe të trupit. Në rutinën e përditshme, njeriu ka nevojë të pushojë, të relaksohet, të marrë frymë me paqe dhe të ndihet i sigurt, por shpesh nuk gjen mundësi për këtë. Në një farë mënyre, namazi, që është si një miraxh për besimtarin, e ndihmon njeriun të largohet nga vështirësitë e kësaj bote dhe të gjejë qetësinë shpirtërore. Drejtimi nga Allahu dhe kërkimi i mbrojtjes tek Ai lehtëson shqetësimet shpirtërore dhe siguron qetësi.

Namazi, që ishte drita e syve të të Dërguarit të Allahut<sup>2</sup> (sallallahu alejhi ve sellem), ndihmon në qetësimin e shpirtit dhe lehtësimin e ndërgjegjes. Namazi qetëson zemrën dhe shpirtin e njeriut dhe i lejon ndjenjat e tij më të holla të marrin frymë. I Dërguari i Allahut ka thënë: "Kur dikush nga ju falet, ai në të vërtetë po flet me Zotin e tij."<sup>3</sup> Kjo tregon se namazi nuk është vetëm një adhurim fizik, por gjithashtu një komunikim i veçantë i bërë me Allahun.

Adhurimi është një burim i begatë që i jep forcë mendimit për mirësinë, bukurinë dhe drejtësinë tek njeriu, si dhe një ndryshim që shndërron prirjet e liga të egos duke e afruar atë me botën e engjëjve. Shpirti që çdo ditë i drejtohet këtij burimi përmes dhikrit dhe meditimit disa herë është futur në rrugën për t'u bërë 'njeriu i përkryer' dhe, në një mënyrë, ka gjetur mburojën e tij për t'u mbrojtur nga intrigat e egos dhe ka forcuar pozicionin e tij.

2. Nesai, Ishretu'n-Nisa; I. Ahmed b. Hanbel, Musned, III, 128, 199.

3. Buhari, Salat, 3.

## 3. Tefekkuri

Meditimi, që nënkupton të menduarit e gjerë, të thellë dhe të sistematizuar mbi çdo temë, sipas njohësve të tij është kandili i zemrës, ushqimi i shpirtit, shpirti i dijes dhe gjaku, jeta dhe drita e jetës islame."

Tefekkuri është të menduarit thellësisht mbi shenjat (ajetet) e krijimit dhe ajetet e Librit të Zotit, për të kuptuar domethëniet dhe mesazhet e shenjta. Ky proces rrit ndërgjegjen shpirtërore të individit, forcon lidhjen e tij me Zotin dhe ndihmon në zbulimin e kuptimit të jetës.

Meditimi, duke reflektuar mbi diturinë, fuqinë, urtësinë dhe bujarinë e pafund të Allahut, largon ndjenjën e pakuptimtësisë që shkakton depresionin. Ai rrit besimin, njohurinë, dashurinë dhe mbështetjen e individit tek Zoti. Mbështetja në Zotin ndihmon në uljen e niveleve të stresit dhe shqetësimit, duke e çliruar mendjen nga mendimet negative dhe duke e pastruar shpirtin. Mendimi mbi bukuritë dhe urtësitë e krijimit bën që personi të ndihet më pozitiv.

Me këtë rast, i tregova nxënësit përjetimet e mia gjatë umres; duke menduar për ekzistencën, njëshmërinë dhe urtësitë e Allahut, kam pasur momente kur u ndjeva e shkëputur nga bota, duke u përqendruar në një thellësi shpirtërore. Aty kuptova se mund të jem plotësisht e dorëzuar me trup, mendje dhe shpirt, pa menduar për asgjë tjetër. Kur ia tregoja këto nxënësit tim, me ndihmën e Zotit, pashë se fytyra e tij ndriçohej. Të jesh i kënaqur me Allahun si Zot dhe të dëshirosh të arrish kënaqësinë e Tij, i largon shqetësimet e njerëzve. Ata që studiojnë diturinë duke ndjekur Kur'anin dhe Sunetin e Pejgamberit, që bëjnë dhikër, që praktikojnë adhurimin dhe reflektimin, duke kërkuar të bëhen njerëz të vërtetë, gjejnë paqe Përmes mendimit mbi mirësitë e shumta të dhëna, kalueshmërinë e botës, mëshirën e pafund të Allahut, dhe mënyrën si Ai i ka pajisur robërit e Tij me dhuratat thelbësore, njeriu jeton në mënyrë të përgjegjshme. Njeriu që merr mësim nga madhësia e pafundme e botës përreth, duke u larguar nga stresi dhe shqetësimi, jeton çdo moment me më shumë vetëdije dhe, duke rishikuar jetën e tij, fillon udhëtimin drejt paqes. Po arritim në fund të bisedës. U përshëndetëm me synimin për t'u takuar përsëri në një tryezë reflektimi të re.

Profeti ynë cakton mësues,  
që të shkonin nëpër qyteza  
të ndryshme dhe t'u mësonin  
njerëzve islamin



## Në Medinë dërgon Musab bin Umejrin

Uruetu bin Zubejri (radijallahu anhu) tregon: "Kur ensarët u bindën, me mendje dhe me zemër, për të gjitha të vërtetat ku i kishte ftuar i Dërguari i Allahut, pasi i kishin dëgjuar me vëmendje të gjitha fjalët e tij, besuan dhe i shprehën besën e plotë që mund të kishte tek ata. (Siç u trajtua edhe më parë, ata gjashtë njerëz që u takuan me të Dërguarin e Allahut në Akabenë e Parë, e që u kthyen për në Medinë me premtimin se do të ktheheshin sërish vitin e ardhshëm, për të kryer detyrimin e Haxhit; ky kthim në Medinë u shndërrua në një të mirë shumë të madhe për ata njerëz.) Po, ata gjashtë njerëz i patën dërguar lajm të Dërguarit të Allahut, ku i thoshin:

- "Na dërgo një njeri nga ata që ke pranë vetes, që t'i ftojë njerëzit, t'i binden Librit të Allahut. Kjo ka për të ndihmuar që njerëzit të njihen më shpejt me Librin." Ata që e prunë këtë lajm, sipas transmetimit, ishin Muadh bin Afra dhe Rafi bin Maliku.

Pas kësaj kërkesë i Dërguari i Allahut dërgoi atje Musab bin Umejrin, që ishte vëlla me bijtë e Abdudarit. Në Medinë Musabi qëndroi në shtëpinë e Es'ad bin Zurares (radijallahu anhu), i cili i përkiste fisit të Beni Ganemit. Bisedonte me ta dhe u lexonte vazhdimisht pjesë të Kur'anit. Bijtë e Nexharit nisën të ushtronin trysni mbi Es'ad bin Zuraren, e, kështu, ata u detyruan që ta largonin Musabin nga shtëpia e tyre. Atëherë Musabi u zhvendos në shtëpinë e Sad bin Muadh. Ai e ndihmoi shumë shpirtërisht, duke i thirrur njerëzit vazhdimisht për te feja e vërtetë e Allahut. Nëpërmjet tij Allahu po i udhëzonte një e nga një të gjithë ensarët, aq sa në tërë shtëpitë e ensarëve vetëm shumë pak shtëpi kishin mbetur pa pranuar fenë islame. Me Islamin që nderuar edhe Amr bin Xhemuhu dhe i gjithë besimi që ai kishte pasur tek idhujt i ishte zhbërë. Musab bin Umejri (radijallahu anhu) u kthye pranë të Dërguarit të Allahut dhe paskëtaj Musabi nisi të thirrej me emrin "Mukri", që do të thotë "Mësues i Kur'anit."

## Profeti ynë cakton mësues për vendasit, Ebu Umamen

Ebu Umameja (radijallahu anhu) tregon: "I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më dërgoi mua, që t'i ftoja njerëzit në fenë e Islamit dhe t'u shpallja atyre shtyllat dhe kushtet e besimit. Kur shkova pranë tyre, ata kishin çuar devetë për të pirë ujë dhe qumështin ua kishin pirë. Kur më panë, thanë:

- "Përsëndetje, Sudaj bin Axhlan! Kemi dëgjuar se edhe ti e ke braktisur fenë dhe ke kaluar në anën e atij njeriu."

- "Jo, unë kam besuar tek Allahu dhe tek i Dërguari i Tij. Resulullahu më ka dërguar që t'ju flas për Islamit dhe urdhëresat e tij.", - u përgjigja unë.

Pastaj, ata shtruan pjata plot me gjak dhe filluan të mblidheshin rreth njëri-tjetrit, për të ngrënë. Më thanë edhe mua:

- "Eja të hash, Sudaj!"

- "Turp t'ju vijë! Unë vij tek ju prej Profetit që e ka shpallur të ndaluar këtë që po hani, sepse e lejuar (hallall), për t'u ngrënë, nuk mund të jetë veçse ajo që është prerë, duke u përmendur emri i Allahut."

- "E ç'na paskësh thënë kështu ai njeri?", - pyetën ata.

- Atij i është zbritur një ajet lidhur me këtë çështje: "Është e ndaluar për ju ngrënia e cofëtinës, e gjakut, e mishit të dërrit, e mishit të kafshës që është therur jo në emër të Allahut, e mishit të kafshës së mbytur në fyt, e mishit të kafshës që është rrahur dhe ka ngordhur, e mishit të kafshës që është vvarë nga rrëzimi, apo nga brirët e kafshëve të tjera, e mishit të asaj që është kafshuar nga egërsirat e tjera - përveç atyre që i therni ju para se të ngordhin. Gjithashtu, është e ndaluar për ju edhe ngrënia e mishit të kafshëve që janë therur për nder të idhujve, apo për të kërkuar fatin në fall. Të gjitha këto që u përmendën, janë gjynah. Sot, dëshpërohen ata që nuk besojnë dhe kanë humbur çdo shpresë, që t'ju largojnë prej fesë suaj. Mos u frikësoni prej tyre, por kini frikë prej Meje! Sot, jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj. Por kushdo që është i shtrënguar nga uria (dhe ha çfarë është e ndaluar), pa pasur qëllim të bëjë gjynah, do ta shohë se Allahu është Falës e Mëshirëplotë." (Maide, 5/3)

Unë nisa t'i ftoja ata të pranonin Islamit, mirëpo, se ç'kish diçka që i bënte të ngurronin.

- "Turp t'ju vijë! Më jepni të paktën një gllënjë ujë, të pi, se po digjem nga etja!" - u thashë.


- "Nuk kemi për të të dhënë ujë, por do të lëmë të vdesësh, kështu, nga etja!"

Me vete kisha edhe çallmën, të cilën e lidha rreth kokës dhe dola, por më kishte zënë gjumi dhe kur u zgjova e gjeta veten të shtrirë mbi rërën përvëluese. Në gjumë erdhi dikush e më dha diçka për të pirë. Ishte një pije, shijen e së cilës nuk e kisha provuar asnjëherë më parë. Ai ma dha atë pije dhe unë e piva; kur e mbarova më doli gjumi. Vërtet, pasi piva atë pije, mua nuk më zuri më asnjëherë etja."

**Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"**


**M. Jusuf Kandehleu**

**Botim i KMSH**



Fetvaja e H. Vehbi Dibrës në  
lidhje me përdorimin e flamurit  
me shqiponjë





***“Në petkat që ka veshur muslimani, nëse ndodhet një figurë e vogël e një gjësë së gjallë, organet e të cilës prej së largu nuk duken, a ka ndonjë pengim?***

*Nuk ka.*

*Nëse gjatë historisë në flamurin tonë është pranuar figura e njohur (shqiponja) dhe duke marrë parasysh se tash heqja e kësaj figure prish bashkimin dhe shkakton përçarje dhe fesat (përçarje) dhe nga kjo ka shumë mundësi, që edhe vendi të pësojë disa reziqe; pra, me qëllim për të ruajtur bashkimin e popullit dhe për të ndaluar mosmarrëveshjet dhe inatet dhe me qëllim që të sigurohet qetësia e përgjithshme, figura e përmendur (shqiponja) a duhet lënë ashtu siç është?*


*Duhet.*

*Kjo fetva është dhënë në bazë të Sheriatit dhe sipas nevojës së kohës dhe vendit... Duhet marrë parasysh se edhe mbretërit osmanë, të cilët janë edhe kalifë, duke patur dekorata, të cilat u jepën nga ana e mbretërve dhe që përmbajnë në to figura e zogj të zinj, venë e falin namazin... Të veprojmë sipas fetvasë së sipërme dhe të druhemi se mos e hedhim vendin në ndonjë greminë shkatërronjëse...*

*Nga ju që jeni personalitetet e rralla, të pajisur me dituri, priten shërbime dhe çdo lloj përpjekje, që të bashkuar në mendime dhe veprime me njëri-tjetrin dhe të bashkuar e nën udhëheqjen e Qeverisë së Re, e cila është një dhuratë e Perëndisë, të shfaqemi... para botës politike dhe kësaj të risim dhe të sigurojmë opinionin politik në favorin tonë.”<sup>1</sup>*

Fetvaja (ligjshmëria islame) e dhënë nga H. Vehbi Dibra në Kuvendin e Vlorës, nuk ishte një lutje fetare, as një përshëndetje e thjeshtë, por një “dekretim” i aktit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.

1. AQSH. Rsh. Fondi, Qeveria e Përkohshme e Vlorës, Dossja III, 5/2 fleta nr. 632, kopja e fetvasë mbajtur në Vlorë nga Kryemyftiu H. Vehbi Dibra, viti 1912.



HAFIZ IBRAHIM DALLIU  
**PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE**

Hafiz Ibrahim Dalliu, personalitet i shquar i arsimit, kulturës e mbarë çështjes kombëtare, është nga ata veprimtarë aktivë që vendin e kanë në piedestalin e kombit, për të cilin punoi dhe iu përkushtua aq shumë, gjatë gjithë jetës.

Përpara se të ndalemi te personaliteti i shquar kombëtar, mësuesi i shqipes dhe i gjuhës së huaj, poeti, publicisti, përkthyesi e luftëtari për pavarësi Ibrahim Dalliu, le të hedhim një shikim të shpejtë të vatrave ku u përgatitën plejada të tëra bijsh shqiptarë, të cilat u trajtuan si "shkolla osmane" që në të vërtetë, në mjaft raste, ishin shkolla shqipe, islame. Atje, dhe në mjedisin familjar e shoqëror, u hodhën bazat e formimit atdhetar të Ibrahim Dalliu. Janë të njohura dokumente hierarkësh të rëndësishëm fetarë, që kanë udhëzuar klerikët të mësojnë gjuhën e vendasve, madje edhe t'ua mësojnë atë brezave të rinj pranë institucioneve fetare.

Medreseja e Isa Beut në Shkup ishte qendër pune e profesorëve dhe shkencëtarëve të shquar, shumë prej të cilëve shqiptarë. Ndër myderrizët (profesorët) që jepnin mësim ishte edhe Isak Çelepiu, i cili që 450 vjet më parë kërkonte një personalitet të lartë për mësuesin, që duhej t'i kushtohej plotësisht këtij profesioni, të ishte mësimdhënës i aftë, njohës i thellë i fushës së tij, si dhe i Sheriatit. Një larmi shkollash të mesme marrin edhe fizionominë e shkollave mikse teologjike-laike me ndonjë dukuri edhe të shkollës së lartë. Ndonëse në kushte të vështira, mjaft shkolla islame, sidomos medresetë, patën një rol progresiv.

Personaliteti i shquar Suzi hoxhë nga Prizreni, poet, historian, mësues e themelues i shkollës fillore në Prizren, i cili hartoi edhe dokumentacionin shkollor, fliste shqip e shkruante gjithashtu në gjuhën amtare me alfabet arab. Mulla Beqiri nga Peja, autor i botimeve shkollore, me përmbajtje nga shkencat, ashtu si edhe Mulla Osmani nga Gjakova ishin në këtë këndvështrim.

Po t'i hynim rreshtimit të personaliteteve në këtë fushë, do të ndaleshim në Shkodër, Ulqin, Berat, Tetovë, Mitrovicë, Pogradec, Elbasan, Strugë, Tiranë, ku gjendemi përpara të dhënave të mësuesve klerikë me veprimtari arsimore, kombëtare, madje edhe si autorë veprash, disa prej të cilave janë përdorur në shkolla të ndryshme. Ka vend për të sjellë trajtimin e mësuesve në shkollat e ashtuquajtura osmane, pa lënë pas dore hulumtimet e shkollave katolike, ortodokse.

Hafiz Ali Ulqinaku punoi në shkollat e Ulqinit, të Lezhës e të zonave përreth, bëri edhe ky atë punë që kreu Kristoforidhi dhe, duke përkthyer

në shqip doktrina fetare, përktheu e solli një mevlud në gjuhën amtare. Megjithatë, edhe pse pati një kulturë e përvojë pedagogjike, ai mbeti i panjohur sa duhej, për të mos thënë më shumë, nisur nga pozita gjeografike ateiste apo antifetare.

Shkolla fetare, seminare, manastire, medrese, që përgatitën disa plejada mësuesish e klerikësh shqiptarë, në mjaft raste kishin në përmbajtjen e tyre, veç lëndëve fetare edhe shkencore, letërsi, gjuhë të huaja, astronomi, histori, gjeografi, madje edhe pedagogji. Vallë, a nuk i shërbyen këto fusha arsimit të masës? Atje u përgatit fillimisht edhe H. Ibrahim Dalliu e disa personalitete të arsimit e të kulturës shqiptare.

Në fotografinë historike të mësuesve e të nxënësve të Shkollës Normale të Elbasanit, të hapur më 1 dhjetor 1909 në Elbasan, bashkë me Luigj Gurakuqin, Aleksandër Xhuvanin e të tjerë ndodhet edhe mësuesi Hafiz Ibrahim Dalliu. Ai ishte pjesëmarrës në kongrese e kuvende të shënuara historike, shok e bashkëluftëtar me nxënësit e kolegët e vet.

Hafiz Dalliu lindi në Tiranë në vitin e ngjarjeve të mëdha, më 1878, në një familje arsimdashëse, atdhetare. Mbaroi shkollën e mesme në atdhe dhe ndoqi 2 vjet shkollën e lartë në Stamboll, të cilën e ndërpreu për arsye ekonomike. Në kushtet e punës e të jetës së tij, problemet e gjuhës shqipe, të shkollës, të arsimit, të publicistikës, krijimtarisë, përbënin probleme të drejtpërdrejta kombëtare për të gjithë shqiptarët.

Si mësues i shkollës shqipe, ai filloi në shkollën e parë shqipe me Filip Ashikun, ndihmoi në hapjen e shkollës së vajzave në Tiranë, më 1908, nga dolën edhe mësueset e para të gjuhës në Tiranë dhe, në fund të vitit 1909 radhitet me mësuesit e Normales së Elbasanit. Punën e tij për këtë shkollë Ibrahim e kishte filluar me kohë, që para Kongresit të Elbasanit, që vendosi për hapjen e Normales, ku pat marrë pjesë si delegat i Tiranës bashkë me Refik Toptanin, Mahmut Fortuzin, Hysni Dalliu, etj.

Themelorja e veprimtarisë arsimore të Ibrahim Dalliu qendron në punën e tij arsimdashëse për ta zhvilluar shkollën në gjuhën amtare, si luftëtar kundër errësirës. Këto i konkretizoi në punën arsimore të drejtpërdrejtë, si dhe në pasqyrimin e pikëpamjeve arsimore në organet e tija "Xhoka" dhe "Dajti", në ligjëratat që mbajti dhe në shkrimet që botoi.

Veprimtaria kombëtare e Hafiz Ibrahim Dalliu rrok një fushë të gjerë pune e lufte, filluar nga gjuha amtare, mësuesi i së cilës ishte në shkollat e Tiranës, e në të tjera në përgatitjen

e brezave shqiptarë në gjuhën amtare dhe me gjuhë të huaja, siç bëri në Elbasan e gjetkë, në fushën e mendimit social-pedagogjik, ku punoi me aq pasion në publicistikë, si autor i dhjetëra e dhjetëra shkrimeve si autor e kryeredaktor, si autor tekstesh në planin e shqipërimit të Kur'anit, e deri në pjesëmarrjen aktive në çetat e luftëtarëve në luftë për pavarësi.

Duke mësuar normalistët, duke punuar me fëmijët e të rinjtë, Hafiz Dalliu u bë i njohur e popullor në masa, çka iu shpërblye me respekt e dashuri. Pranë njerëzve shpirti i tij poetik gjeti edhe frymëzimin për veprat letrare e studimore, me theks të veçantë atdhedashurie si "Grenzat e Kuqe", "Dokrrat e Hinit", "Patriotizma në Tiranë", pamfleti "Triskat e kabineti i Xhafer Ypit", "Një ëndërr e ime", e plot shkrime e artikuj të tjerë. Përreth tre vjet është drejtor i gazetës "Dajti", ku bashkëpunuan firma të nderuara në kombin shqiptar, si Luigj Gurakuqi, Avni Rustemi, etj.

Ai shquhej në trupin pedagogjik të Normales si edukator, në komunikim me nxënësit e tij. Drejtori i asaj vatre të shquar të përgatitjes së mësuesve shqiptarë, Luigj Gurakuqi, shkruan: "Ishim ne: Ibrahim Dalliu, Sotir Peçi, Aleksandër Xhuvani e unë, që po derdhnim djersën tonë brenda asaj shkolle, e po mundoheshim t'i jepnim një fytyrë thjesht kombëtare e ta bënim të zonjën për të ushqyer me dituri e për të rritur si duhet edukatorët e kombit..."

Janë këto ndjenja, ideale e veprime konkrete të përbashkëta që e bëjnë Hafiz Ibrahim Dalliu t'i këndojë nga thellësia e shpirtit, nxënësit të tij, mësuesit e demokratit të shquar Avni Rustemit, me vargjet aq të njohura e tashmë popullore, të krijuara prej tij.

Bërtet polici

Sa u bind Parisi

Kjo pushkë kah krisi

Vallë kush u vra?

Asht vra Esati

Me u shue fesati

Mban zi Serbia

Çirret Greqia

Qan Italia

Për atë që u vra.

Kangë do të këndohen

Gjithmonë pa da.

Ibrahim Dalliu bëri një jetë aktive shkencore e sociale, në radhë të parë atdhetare. Atje ku ishin ngjarjet e mëdha të vendit, atje gjendej edhe Dalliu. Ai bashkëpunoi me Hasan Prishtinën, Luigj Gurakuqin, Aleksandër Xhuvanin, Ismail Ndroqin,

Hasan Voglin, Myslim Llagamin, Musa Maçin, Him Kollin, Xhemal Kondin, Stefan Kojën, Ibrahim Hasnajin, Myrteza Këlliçin, etj. Por, ai u lidh edhe me personalitete të shquara, albanologë të huaj, si Norbert Jokli, e të tjerë, duke u vlerësuar edhe prej atyre.

Hafiz Ibrahim Dalliu mori pjesë në Kongresin e Manastirit, 1908, në atë të Elbasanit, 1909, në ngritjen e flamurit kombëtar në Tiranë dhe në përgatitjen e bazës materiale për në Vlorë, në Kongresin e Lushnjës më 1920, etj. Për veprimtari atdhetare i provoi burgjet radhazi: më 1908 u thirr në prefekturë që t'i bënin presion për të hequr dorë nga problemet e arsimit e të kulturës shqiptare, por ai nguli këmbë se kushtetuta ia jepte të drejtën për të mësuar gjuhën amtare. Ekspedita e Turgut Pashës shtypi me zjarr lëvizjen atdhetare, u mbyllën shkollat shqipe, përfshirë edhe Normalen e Elbasanit. Më 5 shtator 1910 Dalliu gjendet përpara torturave më të egra, sepse kishte shkruar një artikull në formë të një letre të hapur ku dënoheshin xhonturqit e rinj. Ai, si iluminist, pranon se e vetmja rrugë për zhdukjen e injorancës dhe gjendjes së egër është mësimi, por siç shkruante ai, përkundrazi, po përdorej pushka e topi. Injoranca nuk zhduket me top, topi zhduk vetëm njerëzit." Kjo i kushtoi daljen para gjyqit ushtarak bashkë me disa atdhetarë të tjerë, duke u dënuar me 10 vjet burg, nga ku e dërguan në burgun e tmerrshëm të Selanikut, në "Jedi Kule". Edhe shtypi shkruante për torturat çnjerëzore ndaj Dalliu, siç ishte "Dielli" në Boston, "Shkreptima" në Egjipt, etj.


Edhe në burgimet e mëvonshme, në pushtetin e Zogut, të pushtimit fashist edhe pas çlirimit, asnjëherë nuk mbrojt armiqtë e kombit, por gjuhën amtare, kulturën shqiptare, interesat e popullit e të Atdheut, duke mbetur njëkohësisht atdhetar i flaktë e një hoxhë besnik i Kur'anit dhe i fesë islame.

Prandaj, tani ne kujtojmë me respekt të thellë përpara shpirtit dhe mendimit të tij, përpara veprës konsekuente për çlirimin kombëtar nga sundimi i huaj, për gjuhën dhe shkollën shqipe, për luftëtarin e vërtetë të demokracisë në Shqipëri. Koha, brezat do të flasin me nderim për mësuesin e shquar, shkrimtarin, poetin, studiuesin, publicistin, përkthyesin, Hafizin e madh patriot.

**Doc. Musa Kraja**



# *Atalheu*



O Atdhe! Më je i dashur sa më s'ka  
Më je nënë, më je motër, më je vlla.  
Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti më je,  
Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhé.  
Ty përditë të pat parë ime nënë,  
Dheu yt në fund atë e pati ngrënë.  
Nëmëruar t'i pat lulet syri i saj.  
Te ti lindi, te ti vdiq ajo pastaj.  
Ti i ke parë gjysh stërgjyshërit e mi,  
Edhe eshtërat tretur ua ke po ti.  
Nga ti, o shpirt-o kurrë s'qenë ndarë.  
Pranë teje patën qeshur, patën qarë.  
Nëna ime vdiq, ndaj ty të kam sot nënë,  
Nënë që s'ke vdekje kurrë, faqehënë,  
Numri prapë në vend mbetet kurdoherë.  
Begatoje, o Zot, ti këtë vend!  
Epu njerëzve të tij ti mbroth e shend!  
Hi u bëfshin gjithmon' armiqtë e tij!  
Gas përjetë paçin zotërit e tij!  
I begatë, i lulëzuar qoftë ai,  
Një të ardhme pastë plot me lumturi!

**Naim Frashëri**



KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISE

# Kalendari I VITIT 2025

1446 - 1447 HIXHRI